

Një Përrallë Moderne Kosova C 2100

FORUM
2015

Autorë:

Luan Shllaku dhe Ekrem Beqiri, bazuar në raportet sektoriale sintetike të

Sabit Restelica

Bashkim Kabashi

Zeqir Veselaj

Florim Isufi

Xhevat Pllana

Ky hulumtim u realizua me ndihmën teknike të “Qendrës Rajonale të Mjedisit – Zyra në Kosovë”

Botues: Forum 2015

Financuar nga: Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur

Disenj, faqosje dhe shtyp: “Adnan Reznqi CO”

Karikatura: Jeton Mikullovc

Tirazhi: 500

PËRMBAJTJA

7 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

11 HYRJJE

VENDIMMARRJA DEMOKRATIKE

18 Çështja e parë: A duhet prerë së pari, e pastaj matur?

20 Çështja e dytë: A duhen sakrifikuar procedurat demokratike me çdo kusht?

22 Çështja e tretë: Propagandë apo diskutim publik?

SITUATA MJEDISORE

28 Çështja e katërt: A mund të shkohet me ndotje kundër ndotjes?

30 Çështja e pestë: A duhen neglizhuar kufizimet natyrore zhvillimore?

33 Çështja e gjashtë – Sa ka ajër në tymin që thithim?

40 Çështja e shtatë: A duhet Sitnica të jetë kolektor i ujërave të ndotura?

42 Çështja e tetë: A duhet degraduar tokën bujqësore me çdo kusht?

EKONOMIKA E PROJEKTTIT 'KOSOVA C – 2100 MW

48 Çështja e nëntë: A është projekti 'Kosova C' projekt kombëtar apo ndërkombëtar

KONFLIKTE ZHVILLIMORE (MAKROEKONOMIKE?)

52 Çështja e dhjetë: A duhet sakrifikuar bujqësinë?

56 Çështja e njëmbëdhjetë: A kanë ujë ato burime?

60 Çështja e dymbëdhjetë: A duhet rrezikuar edhe më tej shëndetin e popullatës?

64 Çështja e trembëdhjetë: Kënd ndihmon komuniteti ndërkombëtarë - zhvillimin energjetik të Kosovës apo projektin "Kosova C"?

68 PËRFUNDIME

69 REKOMANDIME

PËR FORUM 2015

Forum 2015 është një projekt i Fondacionit SOROS dhe Institutit RIINVEST, që ofron ekspertizë dhe avokon për çështjet zhvillimore në Kosovë. Forum 2015 përmes aktiviteteve të ndryshme, nxit debate mbi tema aktuale dhe ndihmon zhvillimin e një kulture të avancuar politike. Në perspektivë të gjerë, Forum 2015 synon përgatitjen e Kosovës për integrim në struktura Euro-Atlantike.

Tryezat e deritashme të diskutimeve (seminaret dhe konferencat)

Samiti i Selanikut – sfidat e integrimit evropian – 11 Qershor 2003
Platforma e dialogut Prishtinë-Beograd – 7 Tetor 2003
Operacionalizimi i standardeve – 26 Nëntor 2003
Sistemi zgjedhor në Kosovë: përparësitë dhe të metat – Shkurt 2004
Privatizimi në Kosovë: mbarëvajtja dhe pengesat – 9 Mars 2004
Statusi i pronës shoqërore në Kosovë: kontestet dhe privatizimi – 4 Qershor 2004
Kosova pas pesë vitesh: cila është ardhmëria? – 9-10 Korrik 2004
Kosova dhe integrimi i saj në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë – 23 Dhjetor 2004
Mediat në Kosovë: sfidat e gazetarisë së pavarur dhe të qëndrueshme – 21 Mars 2005
Statusi kundër status quos – 1 Qershor 2005
60 vjetori i OKB-së – Një zhvillim për të gjithë – 24 Tetor 2005
Kultura fiskale dhe qëndrueshmëria buxhetore – 19 Janar 2006
Arsimi i lartë për minoritetet në Kosovë – 18 Maj 2006
Dialogu i decentralizimit në Kosovë – 14 Qershor 2006
Arsimi bazik cilësor në funksion të zhvillimit njerëzor – 10 Nëntor 2006
Statusi pas statusit - Prezenca e ardhshme ndërkombëtare në Kosovë – 14 Dhjetor 2006

Publikimet e deritashme të Forum 2015

Privatizimi në Kosovë – Përparimet dhe ngecjet – Mars, 2004
Pse pavarësia? – Shtator, 2005
Kosova pesë vite më vonë – Çfarë agjende për të ardhmen? – 2005
Arsimi i lartë për minoritetet në Kosovë – Shtator, 2006
Arsimi bazik cilësor në funksion të zhvillimit njerëzor – Nëntor, 2006
Decentralizimi në Kosovë – Manual informativ – Janar, 2007
Statusi pas statusit – Prezenca ndërkombëtare në Kosovë – Shkurt, 2007

Një Përrallë Moderne Kosova C 2100



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në Kosovë janë duke u bërë plane për ndërtimin e kapaciteteve të reja termoenergjetike, të cilat, së bashku me zgjerimin e mihjeve ekzistuese të linjitit, do të ndikojnë dukshëm në përkeqësimin e cilësisë së mjedisit. Eksploatimi i linjitit kërkon investime kapitale dhe krahas degradimit të mjedisit sjell edhe shumë efekte tjera negative: zë hapësirë të gjerë, gjeneron lëvizje të dhunshme demografike, zhvendosë vendbanime, varfëron fondin ujorë si dhe dëmton bujqësinë.

Është evidente se Kosova nuk mund ta ndërtojë një të ardhme të qëndrueshme pa e zhvilluar energjetikën. Ajo është e pasur me linjit dhe është e natyrshme që zhvillimi i ardhshëm të jetë i bazuar edhe në shfrytëzimin e këtij resursi të papërtëritshëm. Kjo analizë i hulumton mundësitë e këtij zhvillimi, duke i shqyrtuar planet aktuale të Qeverisë për të ndërtuar një termocentral të ri me kapacitet 2.100MW ('Kosova C'). Pas analizës që i është bërë këtij plani, janë gjetur të paktën 13 arsye që dëshmojnë se ky projekt nuk është i qëlluar dhe nuk ofron zgjidhje të sigurt dhe të qëndrueshme për zhvillimin e energjetikës në Kosovë. Përkundrazi, në këtë analizë argumentohet se projekti 'Kosova C – 2.100MW' do ta ashpërsonte edhe më tej situatën edhe ashtu të rëndë mjedisore, me të gjitha pasojat që do t'i ketë në shëndetin e popullatës, nxitjen e konflikteve zhvillimore ndërmjet energjetikës, bujqësisë, zhvillimit urban dhe rural, si dhe do të nxiste lëvizje sociale-demografike të pafavorshme për zhvillimet e ardhshme të shoqërisë kosovare.

Në këtë raport janë shtruar 13 çështje të cilat do të sjellin probleme të caktuara nëse projekti 'Kosova C' do të realizohej. Këto çështje janë të strukturuar në disa kapituj, ku: i) analizohen problemet e paraqitura gjatë vendimmarrjes dhe promovimit të projektit, ii) pasqyrohet situata mjedisore aktuale dhe ajo pas ndërtimit të termocentralit Kosova C, iii) ofrohen informacione për konfliktet e mundshme ndërsektorale, iv) shqyrtohet skenari ekonomik i propozuar me projekt, v) prezantohen të dhëna për ndikimin e termocentraleve në shëndetin e popullatës, dhe vi) analizohet pjesëmarrja e organizatave ndërkombëtare në zhvillimet e deritanishme në energjetikë, posaçërisht në raport me këtë projekt. Më vijim janë dhënë konstatimet kryesore të kësaj analize lidhur me çështjet e trajtuara në të:

1. Është vendosur të ndërtohet termocentrali Kosova C – 2.100MW para se të bëhen studime dhe analiza ekonomike, sociale dhe, në rend të parë, ekologjike në rajonin ku do të ndërtohet. Thuhet se “më vonë do ta studiojmë dhe analizojmë” nëse ndërtimi i termocentraleve do të jetë i rrezikshëm për shëndetin e popullatës, përfutës për ekonominë dhe i menaxhueshëm në aspektin social.
2. Vendimi për të ndërtuar termocentralin e ri me investim ekskluziv të operatorit të jashtëm është në kundërshtim me strategjinë e aprovuar nga Kuvendi i Kosovës. Janë dy çështje qenësore që kundërshtojnë vendimin e Kuvendit: i) do të ndërtohet më shumë se dyfishi i kapacitetit të paraparë me Strategji dhe ii) e tëra do të bëhet pa investime të përbashkëta, por vetëm me mjete të investitorit të jashtëm.
3. Pretendohet se projekti 'Kosova C' është duke u diskutuar publikisht, në ndërkohë që nuk është duke u përfillur asnjë rregull ndërkombëtar që e cakton përmbajtjen dhe mënyrën se si bëhet diskutimi publik për projekte të tilla madhore.
4. Propagandohet se cilësia e mjedisit pas ndërtimit të termocentralit Kosova C do të jetë më e mirë sesa që është tani! Është evidente se termocentralet Kosova A, B dhe C do të punojnë një kohë relativisht të gjatë së bashku. Gjatë kësaj periudhe ato do të jenë të vendosura shumë afër njëra tjetrës, dhe në këtë mënyrë do ta ndotin mjedisin me ”forca të përbashkëta”.
5. Kosova është një vend shumë i vogël për të absorbuar kapacitete të mëdha eksploatuese dhe për të ndërtuar industri intensive pa e rrezikuar dukshëm mjedisin e saj jetësor. Janë disa faktorë qenësorë kufizues

që do të përcaktojnë kahet dhe mundësitë zhvillimore në të ardhmen: i) dendësia e madhe e popullatës, ii) resurset e kufizuara ujore dhe iii) resurset gjithnjë e më të vogla të tokës bujqësore për banor.

6. Aktualisht termocentralet Kosova A dhe B janë ndotës enormë të ajrit, sidomos në pikëpamje të pluhurit që emetohet nga këto termocentrale. Niveli i emisionit të pluhurit nga tymtarët e Kosova A është 40 herë më i lartë sesa që është përqendrimi maksimal i lejuar i me rregullativat e BE-së, ndërsa ai i emisionit nga Kosova B është 10 herë më i lartë. Pavarësisht nga teknologjitë e reja dhe ndotja më e ulët e ajrit që do të shkaktohej nga Kosova C, situata e përgjithshme me cilësinë e ajrit do të përkeqësohej edhe më tej me ndërtimin e këtij termocentrali.

7. Ndotja enorme e lumit Sitnicë, si të vetmit lumë ku derdhen jo vetëm ujërat e ndotura të termocentraleve por edhe të objekteve tjera të mëdha industriale (Trepça dhe Ferronikeli), si dhe ujërat e zeza urbane të shumë vendbanimeve përreth tij, bën që ai praktikisht të rezultojë në një kolektor të hapur të ujërave të ndotura. Ujërat e ndotura që do të gjeneroheshin si pasojë e ndërtimit të termocentralit Kosova C dhe hapjes së minierës së re nuk kanë ku tjetër të derdhen përpos në këtë lum, gjë që do ta përkeqësojë edhe më tej cilësinë e tij.

8. Sipërfaqe të konsiderueshme të tokës bujqësore do të zihen me hapjen e minierës së re në Fushën e Sibovcit - palosjen e shtresës së zbuluar, formimin e deponive për vendosje të hirit që del pas djegies së linjtit në termocentrale, vendosjen e shiritave për transportimin e linjtit dhe të hirit, dhe ndërtimin e objekteve të kompleksit të termocentralit të ri. Përveç kësaj, ato do të ndoten vazhdimisht, me shtrirje të gjerë përreth nga pluhuri që del nga tymtarët si dhe nga deponitë përkatëse të hirit. Sipërfaqet e ndotura arrijnë deri në 15% të territorit të përgjithshëm të Kosovës.

9. Propagandohet se Kosova do bëhet fuqi eksportuese, gjë që nuk qëndron. Pothuajse i tërë profiti i krijuar me eksport të rrymës do të shkojë në llogari të kompanisë që do të investojë dhe do ta operojë këtë termocentral. Ajo që Kosova do të "eksportoje" është linjiti, i cili do të jetë i vetmi produkt që Kosova do ta shesë, edhe atë me një çmim shumë të vogël, nëse do të realizohet projekti i qeverisë në atë formë si është dhënë. Propaganda tjetër se se projekti 'Kosova C' është një projekt kombëtar është po ashtu larg realitetit; ky projekt ka shumë më shumëtribute ndërkombëtare sesa kombëtare: i) do të operohet nga kompania ndërkombëtare, profiti i realizuar në pjesën më të madhe do të shkojë jashtë Kosovës, dhe ii) Kosova do të ketë telashe ndërkombëtare për t'iu përmbajtur normave mjedisore të përcaktuara ndërkombëtarisht.

10. Me hapjen e minierës sipërfaqësore në Fushën e Sibovcit dhe me ndërtimin e termocentralit Kosova C, një sipërfaqe e madhe do t'i merret bujqësisë, por edhe do të zvogëlohet dukshëm hapësira ku do të mund të zhvilloheshin vendbanimet ekzistuese. Kosova ka shumë pak hapësirë të lirë dhe është e varfër për të organizuar zhvendosje masive të vendbanimeve në zona tjera të lira dhe të pa rrezikuara. Shpërngulja e vendbanimeve nuk mund të bëhet shpejt në vendet e revitalizuara, ku më parë kanë qenë deponitë e hirit apo të djerrinave. Nevojitet të kalojnë afër 50 vjet për tu stabilizuar dheu i rivendosur në gropa, për të ndërtuar shtëpi mbi të, dhe afër 20 vjet për të ndërtuar infrastrukturë rrugore mbi këto sipërfaqe.

11. Të gjitha studimet e gjertanishme tregojnë se faktori më limitues zhvillimor i Kosovës do të jetë mungesa e ujërave. Në këtë kuptim, posaçërisht do të jetë i goditur rajoni ku ndodhet baseni i linjtit aktualisht në shfrytëzim, dhe ku janë të vendosura pothuajse të gjitha objektet e mëdha industriale të Kosovës, siç janë ato të kompleksit të KEK-ut, Trepçës, Ferronikelit, si dhe shumë objekte tjera më të vogla industriale, prodhuese dhe përpunuese. Termocentralet dhe mihjet e linjit janë jo vetëm shfrytëzues të mëdhenj të ujërave por edhe shkaktarë të ndryshimit të regjimit të rrjedhave ujore, si dhe ndotës të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

12. Ndotja e ajrit që vjen nga termocentralet shkakton probleme serioze shëndetësore. Astma, sëmundjet

respiratore, sulmet në zemër dhe vdekjet e parakohshme janë më të shpeshtat. Studimet e bëra nga autorët kosovarë tregojnë se ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet emisionit të gazrave të ndryshme dhe pluhurit nga termocentralet Kosova A dhe Kosova B dhe shpeshtësisë së paraqitjes së sëmundjeve respiratore te punëtorët e termocentraleve dhe minierave, si dhe te popullata që jeton në zonën e ndikimit të këtyre impianteve energjetike. Me ndërtimin e termocentralit Kosova C situata do të përkeqësohet edhe më tej.

13. Meqë organizatat ndërkombëtare (Banka Botërore, AER-i, USAID-i, SIDA) kanë shpenzuar shumë në sektorin e energjisë deri tash duke ndihmuar riparimin e termocentraleve egzistuese si dhe në zhvillimin e energjetikës në përgjithësi, atëherë shumë vështirë mund të kuptohet pse nuk marrin qëndrim konkret karshi ndërtimit të termocentralit Kosova C, i cili në mënyrë të pariparueshme do të mund të ndikojë në zhvillimet e ardhshme në Kosovë, jo vetëm në mjedis, por edhe në ekonomi, bujqësi, zhvillime urbane, demografike, sociale etj. Këto organizata do duhej të prononcohen botërisht se a vërtet qëndrojnë prapa projektit 'Kosova C – 2.100MW, ashtu siç po cilësohen nga MEM-i.

HYRJE

Kosova është e pasur me minerale, posaçërisht me linjit. Rezervat e linjtit¹ vlerësohen të jenë të mjaftueshme për të ushqyer energjetikën kosovare disa qindra vjet të ardhshme. Shfrytëzimi racional i këtij resursi është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e vendit, jo vetëm për shkak të faktit se është burim i papërtëritshëm, por edhe pse shfrytëzimi i tij intensiv dhe i pakontrolluar krijon ndryshime të mëdha strukturore të hapësirës, në rend të parë degradimin e mjedisit jetësor, si dhe konflikte të shumta sociale dhe ekonomike. Kosova është vend i vogël me gjithsej 10.904 km², dhe duhet të ketë vizion të qartë të zhvillimit të saj ekonomik, hapësinor dhe social për t'u mos futur në konflikte të papërballueshme që do ta pamundësonin zhvillimin normal dhe të qëndrueshëm të shumë sektorëve ekonomikë.

Shfrytëzimi i linjtit gjeneron konflikte të shumta zhvillimore. Interesat e shumë aktorëve janë të konfrontuara, dhe vetëm me planifikim të qëlluar aktorët e zhvillimit të resorëve të ndryshëm ekonomikë dhe shfrytëzuesit e hapësirës ku gjenden resurset e linjtit dhe objektet për shfrytëzimin e tij mund t'i konfrontojnë dhe t'i përshtatin interesat e tyre me prioritetet e vendosura dhe me planet makroekonomike të zhvillimit. Këto plane duhet të jenë medoemos në harmoni me prioritetet, standardet dhe kriteret e dala nga studimet komplekse dhe analitike të planerëve kosovarë, si dhe të ofrojnë jo një, por disa skenarë dhe alternativa zhvillimore për ardhmëri, duke i specifikuar efektet pozitive dhe negative të secilës prej tyre.

Mihja dhe eksploatimi i linjtit në Kosovë nuk është studiuar mirë deri tash, edhe përkundër efekteve negative që ushtron në hapësirë dhe në konceptet zhvillimore. Investimet kapitale që ajo lidhë me vete, okupimi i tokës, degradimi i mjedisit, lëvizjet negative demografike si dhe zhvendosja e vendbanimeve e bënë energjetikën një degë të industrisë me efekte të shumëfishta në një zonë të gjerë përreth hapësirës që e okupon, dhe problemet që pasojnë nuk mund të zgjidhen në nivel lokal, dhe as nga vetëm një resor qeveritar i caktuar.

MEM-i ka hartuar Strategjinë e Energjisë së Kosovës për periudhën afatmesme 2005-2015. Po ashtu, kjo ministri ka përgatitur një projekt për ndërtimin e termocentralit Kosova C me fuqi 2.100MW. Shumë aktorë tjerë të jashtëm në Kosovë janë angazhuar të ndihmojnë këtë sektor, në rend të parë Banka Botërore dhe AER-i. Po ashtu, qeveria e Kosovës është para aprovimit të Strategjisë dhe Planit Zhvillimor të Kosovës. Këto tri dokumente, të pakoordinuara sa duhet, përkufizojnë bazën për zhvillimin e energjetikës në Kosovë. Më konkretisht, larg përpara angazhimeve strategjike për të konceptuar zhvillimin e mëtejshëm të energjetikës, dhe të krijimit të një infrastrukture ligjore brenda të cilës do të zhvillohej ky sektor në të ardhmen, qëndron angazhimi i MEM-it për t'i kompletuar aktivitetet për ndërtimin e një termocentrali të ri, me fuqi 2.100MW, që do të operohej nga një investues privat i jashtëm. Sektorët tjerë, të cilët patjetër do të ndikohen nga këto plane dhe kjo qasje janë në gjumë të thellë. Nuk ekziston asnjë analizë sektoriale e ndërhyrjeve, ndikimeve dhe mundësive për bashkëpunim reciprok të sektorëve që preken në mënyrë substanciale nga zhvillimi i projektit 'Kosova C – 2.100MW'. Në rend të parë mendohet në bujqësinë dhe zhvillimin rural, mjedisin, zhvillimin hapësinor, zhvillimin ekonomik dhe social etj. Në këtë analizë jepen disa aspekte të konflikteve ekzistuese dhe atyre që do të vijnë, për shkak të interesave të kundërta të këtyre sektorëve.

Industrializimi i hovshëm, sipas modelit të mirënjohur të dikurshëm socialist, nga fillimi i viteve të 50-ta e deri në fund të 80-tave, kur janë bërë disa investime kapitale në Kosovë, solli një strukturë shumë të papërshtatshme të ekonomisë së ndërtuar, sepse ishte e dominuar nga industria dhe minierat, të bazuara në

1 ESTAP I, Module G, 2002; sipas këtij studimi rezervat çmohen në rreth 14,3 miliardë tonë.

MEM, Resurset minerale të Kosovës, 2005; sipas këtij dokumenti, deri në vitin 2006 janë eksploatuar 270 milionë tonë linjit dhe janë deponuar rreth 400 milionë m³ djerrinë.

eksploatimin e mineraleve. Rreth 70% të mjeteve të investuara i takonin këtij sektori dhe 20% shkonin në energjetikë². Në vitin 1985 është arritur maksimumi i pjesëmarrjes së industrisë në produktin vendor (45%) dhe vetëm një dekenie më pas kjo pjesëmarrje është zvogëluar në 27% duke shkaktuar rënie të dukshme ekonomike. Ky zhvillim ekonomik nuk ishte i përcjell me hapje të vendeve të mjaftueshme të punës: gjatë kësaj periudhe ky sektor ka punësuar mesatarisht vetëm 22% nga numri i përgjithshëm i të punësuarve në Kosovë.

Industrializimi i Kosovës u përcoll nga një proces spontan i urbanizimit që ndikoi dukshëm në bujqësinë kosovare. Pjesëmarrje e saj në prodhimin vendor ka rënë nga 45% në vitet e 50-ta në 30% në vitet 90-ta. Industrializimi dhe deagrarizimi sollën ndryshime të mëdha demografike dhe të rrjetit të vendbanimeve të cilat filluan të koncentroheshin gjithnjë e më shumë rreth Prishtinës, e cila u bë jo vetëm qendër administrative por edhe industriale. Në një distancë shumë të vogël nga ajo janë koncentruar objektet më të mëdha industriale – Termocentralet dhe Industria Kimike e Kastriotit (5 km), Ferronikeli (20 km) dhe Trepça (34 km). Brenda një trekëndëshi shumë të ngushtë Kastriot – Prishtinë – Fushë Kosovë është koncentruar një potencial i gjerë industrial, i cili në vitet e 90-ta lidhte rreth 62% të të punësuarve në këtë rajon të ngushtë dhe 78% të mjeteve themelore të investuara.³ Nga ky koncentrim dalin shumë probleme sociale, mjedisore dhe hapësimore që implikon nevojën për një organizim më të mirë të hapësirës që do të përdoret nga ekonomia, shërbimet publike, infrastruktura dhe popullata në përgjithësi.

Idetë e zhvillimit të sektorit të energjetikës për nevoja vetjake dhe për eksport nuk janë të reja. Ato datojnë nga mesi dhe fundi i viteve të 80-ta dhe gjithmonë ishin iniciuar nga Sistemi Elektroenergjetik i Jugosllavisë (SEJ).⁴ Për herë të parë kjo ide është diskutuar seriozisht në vitin 1984, në qeverinë e atëhershme të Kosovës.

Falë intervenimit kategorik të ekspertëve kosovarë që sollën argumente për ndikimin shumë negativ që do të kishin objektet e reja termoenergjetike, në rend të parë në mjedis, si dhe për shkak të konfrontimit me sektorin e bujqësisë, për shkak të mungesës së ujërave të mjaftueshme për të ushqyer që të dy sektorët, qeveria e atëhershme e refuzoi këtë " ofertë". Tentativa e dytë ishte shumë më kërcënuese. Në vitin 1988 është vendosur zyra për ndërtimin e një termocentrali me fuqi 2.100MW⁵, e cila i filloi hulumtimet komplekse që do të vendosnin bazën për ndërtimin e termocentraleve të reja që do të "eksportonin" rrymë kryesisht në vendet tjera të Jugosllavisë së dikurshme. Projekti 'Kosova C – 2.100MW' paraqet tentativën e tretë për të ndërtuar termocentralin me fuqi 2.100MW. A është e rastit se ky kapacitet gjithmonë vjen si ide e re? Kjo analizë përpiket të sjellë argumente të reja lidhur me të, duke kontestuar shumë parametra të cilët në këtë analizë elaborohen me optimizëm dhe duke sjellë një dritë të re mbi këtë projekt komercial të qeverisë, sidomos në lëmenjtë që aspak nuk janë të përpunuara: mjedisi, vendimmarrja demokratike, ekonomika e këtij investimi, perspektiva sociale dhe demografike. Në fund të analizës janë dhënë rekomandime konkrete që shpresojmë se jo vetëm do ta ngritin nivelin e debatit demokratik për këtë çështje zhvillimore të rëndësishme primare për ardhmërinë e Kosovës, por edhe do t'i ndihmojnë vendimmarrësit për ta analizuar më thellë këtë investim dhe për të gjetur zgjidhje ekonomike sa më të favorshme, më të përgjegjshme dhe më të pastra për qytetarët e Kosovës.

Kosova ka nevojë urgjente për energji elektrike me qëllim që të sigurojë zhvillim të papenguar të ekonomisë aktuale dhe asaj që do të zhvillohet në vitet e ardhshme. Por, Kosova ka po ashtu nevojë për një zhvillim të balancuar mirë, ku eksploatimi i mineraleve, posaçërisht energjetika e bazuar në linjit, nuk do të shihet si i

2 Plan i hapësirës i rajonit të eksploatimit të basenit të linjtit – Baza analitike e planit hapësirës, IAUS, Beograd 1999.

3 Po aty.

4 Kapaciteti i projektuar për ndërtim ka qenë 2.700MW, kurse investitorë është dashur të jenë shtetet e Evropës Qendrore.

5 Programi i hulumtimeve detaje për nevoja të ndërtimit të objekteve të reja termo-energjetike, me fuqi prej 2100 MW, bazuar në ngritjen e prodhimit të qymyrit në basenin e Kosovës, Prishtinë 1989-91. (Grup institucionesh).

vetmi shans për të përparuar ekonominë. Posaçërisht Kosova duhet të ketë kujdes që të mos abuzojë me segmentet më vitale të shoqërisë - cilësinë e mjedisit dhe shëndetin e popullatës së saj. Planerët qeveritarë nuk duhet të bëjnë lëvizje të ngutshme gjatë projektimit të zhvillimit ekonomik, sepse në këtë moment, kur stabiliteti politik dhe ekonomik i vendit është në një pikë mjaft të ndjeshme, Kosova mund të jetë në pozicion shumë të disfavorshëm për të krijuar partneritet me investitorë privatë. Negocimi i ngutshëm i projekteve të mëdha zhvillimore, siç është projekti 'Kosova C – 2.100MW' mund t'i bllokojë perspektivat zhvillimore të këtij dhe sektorëve tjerë të ekonomisë për një kohë të gjatë. Fare lehtë, projekti 'Kosova C – 2100 MW' mund të jetë një projekt i tillë, sepse pas dhënies me koncesion të linjtit një operatori të jashtëm për 40 vitet e ardhshme do të bllokohej ose së paku do të minimizohej mundësia e investimeve tjera në këtë sektorë nga bizneset dhe/ose qeveria kosovare. Në këtë analizë kemi argumentuar se me ndërtimin e termocentralit me fuqi 2.100MW nuk do të mbetet aspak hapësirë për t'i arritur standardet mjedisore, sidomos ato ndërkom-bëtare.

Për të ndërtuar një strategji të përgjegjshme dhe të balancuar të zhvillimit energjetik të vendit duhen studiuar shumë aspekte zhvillimore dhe të sjellën të ndërthurura mes vete, në mënyrë që të mbërrihet një qasje sin-ergjike dhe të evitohen konfliktet potenciale. I tërë rajoni ku do të vendoseshin termocentralet e reja dhe ku ato do të ushtrojnë ndikime të shumta, negative në rend të parë, duhen konceptuar si një hapësirë ku duhet zhvilluar një sistem efikas socio-ekonomik, brenda një hapësire të organizuar në mënyrë racionale që i përm-bush nevojat e zhvillimit human përbrenda potencialeve të ndërtuara më parë dhe atyre që do të ndërtohen në të ardhmen. Çdo zhvillim i ardhshëm duhet të qëndrojë mbi parimet e ekonomisë së tregut, si dhe për-shtatjes strukturore ndaj tregut vendor, rajonal dhe më gjerë. Në sektorin e energjetikës kohëve të fundit ka pasur shumë iniciativa për të sjell një treg unik energjetik regjional (Marrëveshja e Athinës), si dhe iniciativa për ngritjen e bashkëpunimit ndërmjet elektroekonomive të shteteve të regjionit. Ky treg në të ardhmen do të jetë i sfiduar edhe më shumë të bashkëpunojë, sepse trendët aktualë dhe potencialet zhvillimore të energ-jetikës në rajonin e Ballkanit padyshim e imponojnë nevojën për një bashkëpunim shumë më të frytshëm në të ardhmen. Këtij rajoni në periudhën e ardhshme afatmesme do t'i mungon shumë energji.⁶

Ndotja aktuale e mjedisit dhe degradimi i mëtejshëm i cilësisë së tij pas ndërtimit të kapaciteteve të reja en-ergjetike nuk njihen sa duhet në këtë moment. Arsyeja është shumë e thjeshtë: akoma askush nuk ka bërë hulumtime të mirëfillta të mjedisit aktual, si dhe nuk e ka hulumtuar situatën mjedisore që do të krijohet pas ndërtimit të termocentralit Kosova C – 2.100MW. Në anën tjetër, institucionet tona janë të gatshme ta nënshkruajnë menjëherë kontratën për ndërtimin e termocentralit Kosova C – 2.100MW, pa i pasur rezulta-tet e studimeve mjedisore dhe sociale. Ky është njëri nga paradokset që i adreson kjo analizë.

Kur flitet për ndotjen që shkaktojnë termocentralet mendohet kryesisht në emisionin e gazrave dhe grimcave toksike nga tymtarët në ajër, ndotjen e ujërave dhe tokës, zënien e tokës dhe aspekte tjera socio-ekonomike që sjell ndërtimi dhe eksploatimi i termocentraleve me të gjitha objektet dhe infrastrukturën teknike dhe teknologjike që e përcjell prodhimtarinë e energjisë. I tërë cikli ndotës mban në vete shumë operacione: nxjerrjen e linjtit, separimin dhe pastrimin e tij, transportin deri në termocentrale, djegien në vetë termocen-tral, ndarjen dhe transportin e hirit dhe deponimin e tij në deponi.

Eksploatimi i sasive të mëdha të linjtit sjell me vete shumë konflikte. Vlen të përmenden tri sosh: 1) kon-flikti ndërmjet mihjeve sipërfaqësore (minierave të linjtit) dhe bujqësisë, 2) konflikti ndërmjet mihjeve dhe vendbanimeve ekzistuese, dhe objekteve industriale, infrastrukturës, ekonomisë ujore etj., dhe 3) konflikti ndërmjet termocentraleve dhe mjedisit. Këtyre konflikteve duhet shtuar edhe ato që krijohen nga zhvillimi i ulët dhe jo homogjen i vendit, dendësia e lartë e popullimit të hapësirës përreth mihjeve dhe termocentra-leve, papunësia dhe standardi i ulët jetësor.

6 World Bank and European Commission, South east Europe Generation Investment Study – Executive Summary, 2003.

Dhe në fund, qasja ndaj problemeve mjedisore në rrethanat tona, si edhe në shumë vende tjera, zbulon një dimension politik të rëndësishëm – cakton nivelin e demokratizimit të shoqërisë kosovare. Kultura jonë demokratike, përgjegjësia politike dhe niveli i bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare në aplikimin e normave dhe standardeve që garantojnë zhvillim të qëndrueshëm, shprehen fuqimisht nëpërmjet marrëdhënies që shoqëria kosovare do t'i vendosë me ambientin jetësor të saj, e në rend të parë me resurset e saja natyrore. Pavarësisht nga nevojat që do të paraqiten për energji elektrike, fillimisht duhet të mendohet mirë dhe të studiohen mënyrat se si do të prodhohet kjo energji. Dhe, ajo që posaçërisht thuhet në këtë analizë, ne duhet të bëjmë analiza gjithëpërfshirëse dhe të hollësishme ekonomike, ekologjike dhe sociale, të ndërlidhura në mes vete, para se të vendoset për ndërtimin e termocentralit Kosova C – 2.100MW. Dhe këto analiza duhet t'i bëjnë jo institucionet qeveritare lokale, por organizatat kërkimore-shkencore të pavarura.

VENDIMMARRJA DEMOKRATIKE



Çështja e parë:

A duhet prerë së pari, e pastaj matur?

MEM ka vendosur ta ndërtojë termocentralin Kosova C – 2100 MW para se të bëhen studimet dhe analizat ekonomike, sociale dhe, në rend të parë, ekologjike në rajonin ku do të ndërtohet. Lidhur me këtë, MEM-i prononcohet se studimet do të bëhen më vonë, dhe se ato do t'i bëjë operatori i jashtëm, i ndihmuar nga organizatat ndërkombëtare, siç janë Banka Botërore dhe AER-i.. Pra, fillimisht është vendosur, është caktuar edhe kapaciteti i termocentraleve që do të ndërtohen dhe pastaj thuhet se “më vonë do ta studiojmë dhe analizojmë” nëse ndërtimi i termocentraleve do të jetë i rrezikshëm për shëndetin e popullatës, profitabil për ekonominë dhe i menaxhueshëm në aspektin social (zhvendosja e fshatrave nga Fusha e Sibovcit dhe nga lokacioni ku do të ndërtohet termocentrali, lëvizjet demografike, etj.).

VENDIMMARRJA DEMOKRATIKE

MEM-i i ka marr të gjitha ingerencat për të ndërtuar termocentralin Kosova C – 2.100MW. Ka vendosur të ndërtojë, ka vendosur tashmë edhe cilin kapacitet ta instalojë, e ka bërë skenarin investues, udhëheq me Komisionin Drejtues të Projektit⁷, e promovon këtë skenar ndër qytetarë duke e quajtur diskutim publik dhe betohet se do ta realizojë këtë projekt pa marrë parasysh se sa kundërshtohet, duke u prononcuar prore se e gjithë kjo bëhet në emër të “interesave” të sovranit të quajtur popull! Gjatë këtij procesi të vendimmarrjes nëpërkëmben shumë parime, rregulla dhe procedura demokratike.

Çështja e parë: A duhet prerë së pari, e pastaj matur?

Vendimi për ndërtimin e termocentralit Kosova C – 2100 MW është marrë para se të bëhen studimet dhe analizat ekonomike, sociale dhe, në rend të parë, ekologjike në rajonin ku do të ndërtohet. Lidhur me këtë, ai prononcohet se studimet do të bëhen më vonë, dhe se ato do t'i bëjë operatori i jashtëm, i ndihmuar nga organizatat ndërkombëtare, siç janë Banka Botërore dhe AER-i. Pra, fillimisht është vendosur, është caktuar edhe kapaciteti i termocentraleve që do të ndërtohen dhe pastaj thuhet se “më vonë do ta studiojmë dhe analizojmë” nëse ndërtimi i termocentraleve do të jetë i rrezikshëm për shëndetin e popullatës, profitabil për ekonominë dhe i menaxhueshëm në aspektin social (zhvendosja e fshatrave nga Fusha e Sibovcit dhe nga lokacioni ku do të ndërtohet termocentrali, lëvizjet demografike, etj.).

Shumë pyetje logjike mund të shtrohen lidhur me një zhvillim jo logjik të tillë. Është e logjikshme të shtrohen pyetjet se çka do të bëhet nëse: 1) analizat do të tregojnë se parametrat ekologjikë janë shumë negativë dhe se cilësia e ambientit do të përkeqësohet shumë, 2) parametrat ekonomikë nuk janë edhe shumë të favorshëm krahasuar me raportin kost-benefit përkatës,⁸ dhe nëse 3) problemet sociale që do të krijohen nuk do të jetë lehtë të menaxhohen. Logjikisht, ekziston frika reale se nëse operatori i jashtëm, apo/dhe cili do komision qeveritar yni, do të gjendet para rezultateve negative të analizës së bërë ai do duhej ta “menaxhojë” situatën disi, për të vazhduar punën e zotuar më parë me nënshkrimin e kontratës me investitorin e jashtëm. Në këtë situatë me të drejtë do duhej frikuar nga objektiviteti i investitorit por edhe komisioneve qeveritare që do ta vlerësojnë projektin. Mbetet shumë hapësirë për dyshim se rezultatet mund të “kurdisen”.

Do të ishte e natyrshme që planet me interes kombëtar, çfarë janë hapja e mihjes së linjitit në Fushën e Sibovcit dhe ndërtimi i një termocentrali të ri me kapacitet 2.100MW, të janë vlerësuar paraprakisht nga vetë institucionet relevante të Kosovës në pikëpamje të ndikimit në mjedis dhe në shoqëri në përgjithësi, para se gjithash në shëndetin e popullatës. Në këtë mënyrë do të evidentoheshin konturat e kufizimeve të mundshme dhe do të evitohej çfarëdo “befasie” që do mund t'i përgatitej popullatës kosovare dhe zhvillimit të qëndrueshëm të Kosovës.

Se një ecuri e tillë do të ishte e natyrshme e konfirmojnë edhe aktet përkatëse ndërkombëtare, siç është Protokollin VSM (Vlerësimi Strategjik Mjedisor - Strategic Environmental Assessment) i Kievës⁹, sipas të cilit nga palët nënshkruese kërkohet t'i vlerësojnë pasojat e mundshme mjedisore të planeve dhe programeve zyr-

7 Menaxhimi i plotë i projektit dhe kontrolli i është dhënë Komitetit Drejtues të Projektit, i formuar me urdhëresën e PSSP-së të datës 17 mars 2006.

8 Ministria e Energjisë dhe Minierave, Politikat për Tërheqjen e Investitorëve Strategjikë në Sektorin Energjetik të Kosovës, maj 2006.

9 Protokollin është miratuar në një takim të jashtëzakonshëm të palëve nënshkruese të Konventës Espoo, të mbajtur më 21 maj 2003 në Kievë (Ukrainë) gjatë konferencës ministrore ‘Mjedisi për Evropën’.

tarisht të propozuara – shiko kornizën 1. Sipas këtij protokollit, gjatë procesit vendimmarrës VSM-ja duhet të ndërmerret shumë më parë sesa Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM), dhe konsiderohet si mjet kyç për zhvillim e qëndrueshëm të një vendi.¹⁰ Protokollit po ashtu kërkon pjesëmarrje gjithëpërfshirëse të publikut në vendimmarrjen qeveritare për një numër të konsiderueshëm të sektorëve zhvillimorë.

Korniza 1. Përkufizimet dhe lëmenjtë e zbatimit të VSM protokollit¹

Neni 2: PËRKUFIZIMET

5. Me “plane dhe programe” nënkuptohen planet dhe programet dhe ndonjë modifikim i tyre që:

(a) Kërkohen me dispozitat ligjore, rregullatore ose administrative; dhe

(b) I nënshtrohen përgatitjes dhe/ose miratimit nga ndonjë autoritet apo që përgatiten nga ndonjë autoritet për miratim, nëpërmjet një procedure formale, nga një parlament ose një qeveri.

6. “Vlerësim strategjik mjedisor” do të thotë vlerësim i ndikimit të efekteve të mundshme në mjedis, përfshirë shëndetin, të cilat e përmbajnë përcaktimin e qëllimit të një raporti mjedisor dhe përgatitjes së tij, realizimin e pjesëmarrjes publike dhe këshillimeve, dhe përfshirjen e raportit mjedisor dhe rezultateve të pjesëmarrjes publike dhe këshillimeve në një plan apo program.

Neni 4: FUSHA E ZBATIMIT PËRKITAZI ME PLANET DHE PROGRAMET

2. Vlerësimi strategjik mjedisor do të bëhet për planet dhe programet të përgatitur për bujqësinë, pylltarinë, peshkimin, energjinë, industrinë, duke përfshirë edhe minierat, transportin, zhvillimin regional, menaxhimin e hedhurinave, telekomunikacionin, turizmin, planifikimin e fshatrave dhe qyteteve apo shfrytëzimin e tokës, dhe të cilat i caktojnë parametrat për zhvillim të mëtejshëm të projekteve të radhitura në Aneksin I dhe të cilitdo projekt tjetër të radhitur në Aneksin II për të cilin kërkohet një vlerësim i ndikimit në mjedis në kuadër të legjislacionit kombëtar.

Asgjë nga kjo nuk është bërë deri tani. Vetëm thuhet se do të zbatohet teknologji sipas standardeve ndërkombëtare, çka për njohës të çështjeve mjedisore nuk do të thotë shumë, në të vërtetë do të thotë shumë pak, pasi që të shumtë janë indikatorët për atë se a do të ketë apo jo ndikim në mjedis dhe në shëndet të popullatës ndonjë objekt i ri industrial. Kështu, gjithçka i është lënë në mëshirë të vlerësimeve të ndikimit në mjedis të cilat do të servohen nga investitorët e ardhshëm të huaj. Këtë e konfirmon vetë Korniza Strategjike për Përfshirjen e Kapitalit Privat në mënyrë me efikase dhe praktike¹¹, sipas të cilës projekti për ndërtimin e termocentralit të ri zhvillohet në disa faza: i) definimi i projektit dhe përzgjedhja e zhvilluesit, ii) disenjimi i projektit dhe aprovimi i planit të projektit, iii) ekzekutimi i marrëveshjeve të projektit, përfshirë ato financiare dhe iv) ndërtimi i projektit.¹² Siç shihet, askund nuk parashihet hartimi i VSM-së si parakusht për projekte të tilla, por specifikohet se “zhvilluesi i sektorit privat do të zgjidhet me një proces transparent para fundit të vitit që të definojë projektin dhe të prezantojë, në një afat kohor që do të specifikohet, një plan që do t’i

¹⁰ www.unece.org/env/cia/sea_protocol.htm.

¹¹ Prezantimet në “International Energy and Minig Investors’ Conference”, të mbajtur në Prishtinë më 10-11 tetor 2006. (<http://www.ks-gov.net/mem/english/index.html>)

¹² Ministria e energjisë dhe minierave, Politikat për Tërheqjen e Investitorëve Strategjik në Sektorin Energjetik të Kosovës, maj 2006.

Çështja e dytë:

A duhen sakrifikuar procedurat demokratike me çdo kusht?

MEM-i propagandon se Korniza strategjike e saj për përfshirjen e kapitalit privat në hapjen e minierave të reja të linjtit dhe ndërtimit të termocentralit të ri me fuqi 2.100MW mbështetet në vendimet e institucionit më të lartë shtetëror të Kosovës – Kuvendit të Kosovës. Një konstatim i tillë nuk qëndron, dhe mundet fare lehtë të verifikohet. E vërteta e vetme është se në Strategji thuhet se “do të lëshohen në punë njësi të reja të TC me fuqi prej rreth 1.000MW nëpërmjet investitorëve strategjikë, përkatësisht investimet e përbashkëta”. Pra vendimi i MEM për të ndërtuar 2.100 MW me investim ekskluziv të operatorit të jashtëm, është në kundërshtim të plotë me strategjinë e aprovuar nga Kuvendi. Janë dy çështje kryesore që kundërshtojnë vendimin e Kuvendit: i) do të ndërtohet më shumë se dyfishi i kapacitetit të paraparë me Strategji dhe ii) e tëra do të bëhet pa investime të përbashkëta, por vetëm të investitorit të jashtëm.

Çështja e dytë: A duhen sakrifikuar procedurat demokratike me çdo kusht?

MEM-i propagandon se Korniza strategjike e saj për përfshirjen e kapitalit privat në hapjen e minierave të reja të linjtit dhe ndërtimit të termocentralit të ri me fuqi 2.100MW mbështetet në vendimet e institucionit më të lartë shtetëror të Kosovës – Kuvendit të Kosovës. Një konstatim i tillë nuk qëndron, dhe mundet fare lehtë të verifikohet. E vërteta e vetme është se në Strategji thuhet se “do të lëshohen në punë njësi të reja të TC me fuqi prej rreth 1.000MW nëpërmjet investitorëve strategjikë, përkatësisht investimet e përbashkëta”. Pra vendimi për të ndërtuar 2.100MW me investim ekskluziv të operatorit të jashtëm, është në kundërshtim të plotë me strategjinë e aprovuar nga Kuvendi. Janë dy çështje qenësore që kundërshtojnë vendimin e Kuvendit: i) do të ndërtohet më shumë se dyfishi i kapacitetit të paraparë me Strategji dhe ii) e tëra do të bëhet pa investime të përbashkëta, por vetëm të investitorit të jashtëm.

I gjithë ky devijim bëhet në mënyrë mistike, sikur mos të ekzistonin vendimet e shkruara të Kuvendit, sikur arsyet për të aprovuar strategjinë e tillë të kishin avulluar edhe nga mendja e vetë autorëve të strategjisë dhe miratuesve të saj. Në këtë mënyrë, duke marrë vendime të paanalizuara paraprakisht, MEM-i me ngut, me ose pa vetëdije, me interes ose pa interes, anashkalon edhe procedurat më elementare demokratike sipas të cilave organi i cili ka miratuar strategjinë është i vetmi organ që mund edhe ta ndryshojë atë. Me gjasë logjika mbizotëruese e “shpjegimit” lidhur me këtë projekt madhor është se kohërat e tanishme janë kohëra të sakrificës për çështjen e statusit politik të Kosovës, kështu që në emër të kësaj duhen sakrifikuar edhe procedurat demokratike.

Në shumësinë e problemeve të pasluftës të vitit 1999 dhe të periudhës transitore shoqërore, çështja e problemeve të prodhimit dhe menaxhimit të furnizimit dhe inkasimit të pagesës së energjisë ka shtruar domosdonë e hartimit të një strategjie më afatgjate të tërësisë energjetike në Kosovë. Bazuar në këtë dhe në Ligjin për Energjinë,¹⁴ në vitin 2005 hartohet dhe në Kuvendin e Kosovës miratohet Strategjia e Energjisë së Kosovës 2005-2015.¹⁵

Sipas këtij dokumenti (shiko kornizën 2), tri janë elementet kyçe të orientimit strategjik të Kuvendit të Kosovës lidhur me prodhimin e energjisë elektrike në të ardhmen:

- ndërtimi i kapaciteteve të reja të termocentralit të jetë deri në 1.000MW,
- investitorë të jenë edhe investitorët kosovarë,
- ndërtimit të çfarëdo kapaciteti të ri duhet t'i paraprijnë studimet e detajuara lidhur me shumë faktorë.

Mbështetur në këto elemente, është e qartë se orientimi i tanishëm për ndërtim të termocentralit të ri me kapacitet 2.100MW bie ndesh me orientimin strategjik të Kuvendit të Kosovës. Kjo do të thotë se ky orientim është bërë krye në vete, pa u miratuar në Kuvend ndonjë strategji e re dhe pa u debatuar në të fare çështja e ndërtimit të një termocentrali të ri.


14 Strategjia e Energjisë së Kosovës e ka bazën ligjore në Ligjin për Energjinë. Sipas nenit 4 të Ligjit “Strategjinë e Energjetikës së Kosovës e aprovon Kabineti i Ministrave ndërsa e miraton Kuvendi i Kosovës”.

15 Strategjia së pari është aprovuar nga ana e Qeverisë dhe më pas është përcjellë për aprovim në Kuvendin e Kosovës. Deputetët e kanë marrë Strategjinë më 18 gusht 2005, ndërsa Strategjia është aprovuar në seancën e Kuvendit të filluar me datën 28 shtator 2005 dhe përfunduar me 5 tetor 2005.

Çështja e tretë:

Propagandë apo diskutim publik?

MEM-i ka filluar ta propagandojë projektin ‘Kosova C - 2.100MW’ që pothuajse dy vite, dhe këtë propagandë vazhdon ta bëjë edhe më tej, por tani duke e quajtur diskutim publik. Mënyra se si është duke e prezantuar këtë “diskutim publik” në media krijon përshtypjen se institucionet kompetente po bëjnë gjithçka që është e nevojshme për ta informuar publikun, bile edhe më tepër sesa që e obligojnë normat ndërkombëtare!



Çështja e tretë: Propagandë apo diskutim publik?

Korniza 2. Orientimi strategjik i Kuvendit të Kosovës lidhur me prodhimin e energjisë elektrike²

Prodhimi i energjisë elektrike do të orientohej në përmbushjen e kërkesave të konsumatorëve vendas për energji elektrike me prodhim stabil pa ndërprerje dhe me çmime konkurrense si dhe eksportin e tepërcave në tregun rajonal të energjisë dhe më gjerë.

Për këtë qëllim nevojitet:

- Operimi normal i TC Kosova B dhe HC Ujmani.
- Revitalizimi i blloqeve të Kosovës A (varësisht nga konkluzat e studimit të fizibilitetit).
- Lëshimi në punë i njërive të reja të TC me fuqi prej rreth 1000 MW nëpërmjet investitorëve strategjikë, përkatësisht investimet e përbashkëta.
- Ndërtimi i HC Zhur me koncesion, sipas studimit të fizibilitetit.
- Stimulimi i ndërtimit të HC të vogla nga investitorët privatë.

Në bazë të kësaj do të plotësohen kërkesat e vendit për energji elektrike, do të eksportohen rreth 30-50% të energjisë në sajë të disponimit me kapacitete me fuqi neto prej 1800-2000 MW.

Ndërtimi i kapaciteteve shtesë mbi nivelin e përmendur më lartë për prodhimin e energjisë elektrike në lokacionin e tanishëm të TC Kosova B ose gjetiu, është një opsion që duhet studiuar dhe vlerësuar nga aspekti i efekteve të tij zhvillimore për Kosovën, për mundësitë e eksportit duke pasur parasysh kërkesën e paplotësuar në rajon, por gjithashtu edhe të efekteve në zhvillimin urban e hapësinor, në mjedis, në shfrytëzimin e ujit. Varësisht nga këto mundësi Kosova mbetet e hapur dhe e interesuar që të zhvillojë bashkëpunim me investitorë strategjikë (prodhues të pavarur) të brendshëm dhe të jashtëm.

MEM-i ka filluar ta propagandojë projektin ‘Kosova C - 2.100MW’ që pothuajse dy vite, dhe këtë propagandë vazhdon ta bëjë edhe më tej, por tani duke e quajtur diskutim publik. Mënyra se si është duke e prezantuar këtë “diskutim publik” në media krijon përshtypjen se institucionet kompetente po bëjnë gjithçka që është e nevojshme për ta informuar publikun, bile edhe më tepër sesa që e obligojnë normat ndërkombëtare!

“Diskutimi publik” jo që s’është vërtet i tillë, por propaganda e bërë e bën atë edhe qesharake. Kështu në materialin propagandues të shkurtit 2007 citohet një letër ku pretendohet se një qytetare e Gjakovës i paska shkruar MEM-it: “Faleminderit shumë herë për qasjen dhe përfshirjen e qytetarit të zakonshëm në këtë projekt kapital për Kosovën. Faleminderit që po na pyesni...” (Linda Dana, Gjakovë). Për njohësit e normave dhe standardeve ndërkombëtare që përkojnë me këtë çështje, pretendimi se është duke u bërë diskutimi publik është larg për t’u cilësuar i tillë. Shumë më afër mendjes që i tërë aktiviteti i tanishëm rreth kësaj çështjeje të cilësohet si vetëm një propagandë, e jo përfillje e respektim i normave ndërkombëtare, çfarë është p.sh. Konventa e Aarhusit,¹⁶ njëra ndër konventat më të respektuara ndër anëtarët e BE-së.

Informatat që u ofrohen qytetarëve, qoftë në mediat e shkruara qoftë në disa nga të ashtuquajturat diskutime

¹⁶ “Convention on a Access to Information, Public Participation in Decision-Making and Access to Justice in Environmental Matters”; kjo konventë është miratuar më 25 qershor 1998 në qytetin danez Aarhus, në Konferencën e Katërt Ministrore si pjesë e procesit “Mjedisi për Evropë”. Konventa ka hyrë në fuqi më 30 tetor.

publike, përmbajnë vetëm karakteristika të një projekti të mundshëm komercial për ndërtimin e termocentralit Kosova C, me kapacitet 2.100 MW. Mënyra se si promovohet ky projekt është larg standardeve të përcaktuara me Konventën e Aarhusit, sepse qytetarët informohen vetëm për karakteristikat e këtij projekti investues, dhe atyre nuk u jepet asnjë informacion lidhur me çështjet vijuese:

- i) cilësinë e mjedisit tash dhe pas fillimit të punës së TC-ve të reja,
- ii) gjendjen shëndetësore të popullatës dhe sigurinë e tyre,
- iii) konfliktet sociale që ky projekt do t'i sjell dhe mënyrën se si do të zgjidhen ato.

E vërteta është se nuk ekziston asnjë e dhënë relevante e kësaj natyre dhe se nuk është e mundur të bëhet diskutimi i mirëfilltë publik sipas standardeve dhe konventave ndërkombëtare pa disponuar me të dhëna të tilla. Qeveria është e obliguar që t'i konsideron qytetarët si pjesë përbërëse të sistemit qeverisës, duke iu mundësuar të ushtrojnë të drejtën e tyre për t'u informuar për gjendjen e mjedisit dhe projektet që do të

Korniza 3. Çka paraqet Konventa e Aarhusit?³

Konventa e Aarhusit vendos një numër të caktuar të të drejtave për qytetarët (individët dhe shoqatat e tyre) në lidhje me mjedisin. Nënshkruesit e Konventës duhet t'i krijojnë kushtet e duhura në mënyrë që autoritetet publike (në nivel kombëtar, rajonal ose lokal) të kontribuojnë që këto të drejta të bëhen efektive. Konventa parasheh:

- të drejtën e secilit për të marrë informata mjedisore, të cilat disponohen nga autoritetet publike ("qasje në informata mbi mjedisin"). Këtu përfshihen informatat mbi gjendjen e mjedisit, por edhe mbi politikat ose masat që ndërmerren, apo mbi gjendjen e shëndetit dhe sigurisë njerëzore aty ku mund të ndikohen nga gjendja e mjedisit. Kërkuuesi i informatës duhet të pajiset me këtë informatë brenda një muaji nga paraqitja e kërkesës, pa pasur nevojë të ofrojë sqarime pse i nevojitet kjo informatë. Për më tepër, autoritetet publike janë të obliguara, me Konventë, t'i shpërndajnë informatat mbi mjedisin të cilat i posedojnë;
- të drejtën për të marrë pjesë në vendimmarrjen mjedisore. Autoritetet publike duhet t'i krijojnë mekanizmat për të siguruar që publiku dhe OJQ-të mjedisore të shfaqin komentet e tyre, për shembull, lidhur me propozimet për projekte me ndikim në mjedis, ose për planet dhe programet që lidhen me mjedisin, që komentet të të merren parasysh gjatë vendimmarrjes, dhe që vendimi final të publikohet si informatë bashkë me arsyetimin e duhur për një vendim të atillë ("pjesëmarrja publike në vendimmarrjen mjedisore")
- të drejtën e shqyrtimit të procedurave për t'i sfiduar vendimet publike që janë marrë pa i respektuar dy të drejtat e lartpërmendura ose ligjin mbi mjedisin në përgjithësi ("qasja në drejtësi").

ndikojnë në cilësinë, si dhe për të marrë pjesë në fazat e hershme të procesit të vendimmarrjes për planet dhe programet që ndikojnë mjedisin e caktuar. Këto principe janë të vendosura në Konventën e Aarhusit, të cilën deri tani e kanë nënshkruar mbi 40 shtete, kryesisht evropiane, pjesë të së cilës janë dhënë në kornizën 3.¹⁷Kohëve të fundit MEM-i ka mbajtur disa tubime në vende të ndryshme të Kosovës – me gra, intelektualë,

17 Rregullorja (EC) N° 1367/2006 e Parlamentit të Evropës dhe Këshillit mbi aplikimin e parimeve të Konventës Aarhus mbi institucionet dhe organet e Bashkësisë Evropiane, hyri në fuqi më 28 Shtator 2006. "Rregullorja Aarhus" nuk i mbulon vetëm institucionet, por edhe organet, zyrat apo agjencitë e themeluara në bazë të Traktatit të KE. Të gjitha këto duhet që deri më 28 Qershor 2007 t'i përshtasin procedurat dhe praktikët e tyre brendshme parimeve të Rregullo-

akademikë, qytetarë. Kjo do të ishte në rregull për qëllime tjera, por jo edhe për hapjen e minierës së re në sipërfaqe shumë të madhe (mbi 1.700 hektarë) dhe ndërtimin e një termocentrali të ri me kapacitet të madh (2.100MW), me problemet e të cilave nuk janë të ndikuar popullata as në Pejë, as në Gjakovë, as në Prizren etj., por popullata e cila jeton në Fushën e Sibovcit dhe në regionin e gjerë të Kastriotit, pa mohuar ndikimin edhe në Prishtinë dhe rrethinë. Pra, e logjikshme do të ishte që të fillohet me debate të vërteta publike në Fushën e Sibovcit dhe në Obiliq, e jo gjetiu. Këtë e thotë edhe Konventa e Aarhus-it - shiko kornizën 3. Sipas kësaj konvente, popullata ka të drejtë të informohet, konsultohet dhe të jetë pjesë e vendimmarrjes për plane dhe projekte me ndikim mjedisor. Pothuajse asgjë nga kjo nuk është realizuar lidhur me projektet në fjalë dhe popullatën e cila do të jetë drejtpërdrejt e ndikuar nga këto projekte.

Ç'është më e rëndësishmja, ka munguar faza e konsultave me popullatën e Fushës së Sibovcit lidhur me propozimet për ndërtimin e termocentralit Kosova C – 2.100MW dhe hapjen e minierës në këtë fushë. Kjo është bërë e ditur vetëm në fund të vitit 2006, kur mediat vunë në pah se popullata e kësaj fushe nuk ka qenë e informuar fare lidhur me këtë çështje. Kështu, në një artikull të botuar në të përditshmen “Express” të datës 1 nëntor 2006, drejtori i shkollës fillore në Sibovc, z. Sejdi Sadiku, deklaron: “Thënë të vërtetën, ata të gjithë vijnë këtu nga Prishtina për fushatë politike dhe për interesat e tyre personale. Ne si fshatarë, të gjithë jemi të brengosur; tani sa kemi dëgjuar se investitorët e ri do të emërohen, dhe kur të vijnë ata nuk do të na pyesin për asgjë. Ata kanë arsye, mirëpo populli ynë nuk duhet të lehet anash.”. Se kjo popullatë nuk ka qenë e informuar dhe konsultuar fare është konfirmuar edhe nga vetë kryetari i komunës së Obiliqit, z. Ismet Hashani, i cili në një takim të organizuar nga MEM-i me struktura të ndryshme civile dhe institucionale deklaron, përveç tjerash, se “do të kërkojë referendum nga ana e komunitetit të Kastriotit që ata vetë të thonë nëse duan të jetojnë ende në tymin e elektranave”.¹⁸

Shtrohet pyetja e logjikshme: pse kështu? Shpjegimi është i thjeshtë! Po qe se lehen anash proklamatat boshe, aktualisht nuk disponohet me të dhëna relevante mbi përkeqësimin e cilësisë së mjedisit, i cili do të rezultojë si pasojë e ndërtimit të termocentralit të ri dhe hapjes së minierës së re, siç nuk disponohet as me të dhëna mbi përkeqësimin e shëndetit të popullatës përreth që do të shkaktohet me këto plane.

Qëllimi i diskutimit publik është që brengosjet e arsyeshme të popullatës të merren parasysh gjatë procedimit të mëtejshëm të planeve dhe projekteve me ndikim në mjedis dhe në shëndetësi të popullatës. Në këtë mënyrë popullata e ndikuar bëhet pjesë e vendimmarrjes, çka edhe kërkohet me Konventën e Aarhus-it. Marrë parasysh mënyrën e tanishme të menaxhimit të “debateve publike”, është më se evidente se popullata e Fushës së Sibovcit dhe hapësirave tjera përreth nuk do të bëhen pjesë e vendimmarrjes lidhur me planet për ndërtimin e termocentralit të ri Kosova C – 2.100MW dhe hapjes së minierës së re.

res.

18 Koha ditore, 21 dhjetor 2006; për arsye të panjohura, kryetari Hashani pas një kohe mjaft të shkurtër e ndryshon mendimin.

SITUATA MJEDISORE



Çështja e katërt:

A mund të shkohet me ndotje kundër ndotjes?

MEM-i dhe MMPH-ja propagandojnë se cilësia e mjedisit pas ndërtimit të termocentralit Kosova C do të jetë më e mirë se që është tani!^s Vështirë është ta cilësosh në mënyrë të drejtë propagandën e tillë: është ajo mosnjohje e patolerueshme e problemit, apo është edhe një arrogancë në vazhdën e shumë sosh që vijnë nga ana e disa institucioneve vendimmarrëse, për ta dëshmuar “superioritetin” e tyre të trilluar ndaj organizatave dhe individëve që mendojnë ndryshe. Sidoqoftë, është evidente se deklaratat e proklamuar në kuadër të kësaj propagande janë plotësisht të paargumentuara dhe shumë larg realitetit. Ndërtimi i termocentralit Kosova C nuk do ta zvogëlojë ndotjen e mjedisit, por, përkundrazi, do ta ndot edhe më tepër atë.

Çështja e katërt: A mund të shkohet me ndotje kundër ndotjes?

MEM-i dhe MMPH-ja propagandojnë se cilësia e mjedisit pas ndërtimit të termocentralit Kosova C do të jetë më e mirë se që është tani!¹⁹ Vështirë është ta cilësosh në mënyrë të drejtë propagandën e tillë: është ajo mosnjohje e patolerueshme e problemit, apo është edhe një arrogancë në vazhden e shumë sosh që vijnë nga ana e disa institucioneve vendimmarrëse, për ta dëshmuar “superioritetin” e tyre të trilluar ndaj organizatave dhe individëve që mendojnë ndryshe. Sidoqoftë, është evidente se deklaratat e proklamuar në kuadër të kësaj propagande janë plotësisht të paargumentuara dhe shumë larg realitetit. Ndërtimi i termocentralit Kosova C nuk do ta zvogëlojë ndotjen e mjedisit, por, përkundrazi, do ta ndot edhe më tepër atë.

Është logjikë elementare se nëse dy ose më shumë ndotës të mjedisit veprojnë në afërsi ndaj njëri tjetrit, atëherë efekti i përbashkët kurrësi nuk do të jetë anulimi i ndotjes por fuqizimi i saj, përkatësisht efekti i përbashkët do të jetë një ndotje më e madhe sesa që është ndotja e shkaktuar veç e veç. Kjo do të ndodh edhe në të ardhmen, kur për një kohë ndotja do të shkaktohet nga tri termocentrale - nga dy ekzistueset (Kosova A dhe B)²⁰ dhe nga ajo që do të ndërtohet (Kosova C). Gjatë kësaj periudhe të punës së tyre, por edhe pas mbylljes eventuale të termocentralit Kosova A, të vendosura shumë afër njëra tjetrës, termocentralet do ta ndotin mjedisin me “forca të përbashkëta”. Kështu, në vend që Kosova C të ndërtohet me investime të përbashkëta, të jashtme dhe kosovare, ashtu siç është paraparë me Strategjinë e Energjisë të Kosovës,²¹ sipas planeve aktuale të ndërtimit të termocentralit Kosova C, vetëm ndotja do të jetë e përbashkët.

Në kampanjën e tyre propaganduese këto ministri e kanë thjeshtëzuar shumëfish perceptimin për ndotjen nga termocentralet, duke e kufizuar atë vetëm në tymin që del nga tymtarët. Për më tepër, efekti i emisionit të ndotjes nga tymtarët, mihjet dhe deponitë shihet si i izoluar, përkatësisht si të ishin tymtarët larg njëri prej tjetrit me qindra kilometra, e jo që do të gjenden të gjithë në të njëjtin vend.

Propagandohet se teknologjitë që do të zbatohen do të jenë sipas standardeve evropiane, duke krijuar kështu iluzion se çdo gjë do të jetë perfekte, pra pa ndotje! Të dy këto institucione harrojnë, ose nuk janë në dijeni fare, se sot nuk ekziston kurrfarë teknologjie ‘tërisht e pastër’. Të gjitha ato janë, në shkallë më të vogël ose më të lartë, ndotës të mjedisit, kështu që është injorancë të thuhet se termocentrali i ri “jo vetëm që nuk do ta shton ndotjen e mjedisit, por edhe do ta zvogëlojë atë”. Logjika këtu është shumë e thjeshtë: nëse dy pajisje që gjenerojnë ndotje gjenden njëra pranë tjetrës, ndotja e përbashkët nuk zbritet por mblidhet! Nuk merret parasysh, pra, fakti se ndotja që e shkaktojnë të gjithë tymtarët ekzistues të termocentraleve Kosova A dhe B dhe më vonë edhe Kosova C bashkërenditet, dhe se te qytetarët që jetojnë në një distancë të caktuar nga termocentrali vjen si ndotje e përbashkët, e mbivendosur njëra mbi tjetrën, duke e ngritur në këtë mënyrë dukshëm përqendrimin e gazrave helmues apo të ndotësve tjerë që emitohen. Një situatë e tillë është ilustruar në figurën 1, në të cilën është paraqitur shtrirja e ndotjes së shkaktuar nga mihjet ekzistuese të linjtit dhe nga deponitë e hirit të termocentraleve A dhe B.²² Siç shihet nga kjo figurë, në disa hapësira ndotja me

grimca të pluhurit dyfishohet, kurse në disa tjera edhe trefishohet. Duhet theksuar se, në kushte të caktuara, efekti i ndotjes me pluhur nga këta emetues mund të shtrihet edhe deri në 20km. Po të merren parasysh edhe emisionet nga termocentrale, ndotja me këto grimca mund të shtrihet edhe deri në 40km në drejtim të

19 Një propagandë e tillë është bërë pothuajse në të gjitha “diskutimet publike” të organizuara deri tani nga ana e MEM-it, por edhe nga zyrtarë të lartë ministrorë, përfshirë këtu ministrin e MMPH-së.

20 Sipas planeve të tanishme, termocentrali Kosova B do të jetë në funksion deri në vitin 2025.

21 MEM, Strategjia e Energjisë së Kosovës 2005-2015, Prishtinë, 29 korrik 2005.

22 Carl Bro Group, Environmental Impact Assessment and Action Plan for Kosovo A and B Power Plants and Coal Mines. Environmental Action Plan, June 2003.

juglindjes. E ngjashme është situata edhe me ndotjen e ajrit.




Figura 1. Shpërndarja e pluhurit të emetuar nga deponitë dhe minierat e linjtit të termocentraleve Kosova A dhe B

Propaganda për “mosbrengosje” të popullatës nga ndotja në të ardhmen përqendrohet pothuajse vetëm në ndotjen që shkaktohet në ajër. Kjo qasje le anash shumë veprime tjera negative në ujëra dhe tokë, duke e krijuar kështu një fotografi të mangët të tërësisë së ndotjes që do të shkaktohet nga termocentrali i ri dhe miniera e re.

Çështja e pestë:

A duhen neglizhuar kufizimet natyrore zhvillimore?

MEM-i po tregohet shumë “zemërgjerë” me planin e tij për shfrytëzim ekstensiv të nëntokës së Fushës së Sibovcit për ndërtim të termocentralit të ri me kapacitet të madh (2.100MW). Kjo “zemërgjerësi” është e pakuptueshme për çdonjërën që ka sado pak njohuri mbi Kosovën dhe faktorët përkatës kufizues të zhvillimit të saj, pasi që kjo ministri po sillet si të ishte Kosova ndonjë shtet me resurse të bollshme natyrore, Kanada apo e ngjashme, pa rreziqe të ndotjes enorme të mjedisit dhe shëndetit të popullatës, dhe pa pengesa aktuale zhvillimore. “Harrohet” se Kosova është një vend shumë i vogël për të pranuar kapacitete të mëdha eksploatuese dhe për të ndërtuar industri intensive pa e rrezikuar dukshëm ambientin e saj jetësor.

Çështja e pestë: A duhen neglizhuar kufizimet natyrore zhvillimore?

MEM-i po tregohet shumë “zemërgjerë” me planin e tij për shfrytëzim ekstensiv të nëntokës së Fushës së Sibovcit për ndërtim të termocentralit të ri me kapacitet të madh (2.100MW). Kjo “zemërgjerësi” është e pakuptueshme për çdonjërin që ka sado pak njohuri mbi Kosovën dhe faktorët përkatës kufizues të zhvillimit të saj, pasi që kjo ministri po sillet si të ishte Kosova ndonjë shtet me resurse të bollshme natyrore, Kanada apo e ngjashme, pa rreziqe të ndotjes enorme të mjedisit dhe shëndetit të popullatës, dhe pa pengesa aktuale zhvillimore. “Harrohet” se Kosova është një vend shumë i vogël për të pranuar kapacitete të mëdha eksploatuese dhe për të ndërtuar industri intensive pa e rrezikuar dukshëm ambientin e saj jetësor.

Planet aktuale për hapjen e minierës së re dhe ndërtimin e termocentralit të ri, me kapacitete shumë të mëdha, nuk marrin parasysh faktin se në Kosovë janë disa faktorë qenësorë kufizues që do të përcaktojnë kahet dhe mundësitë zhvillimore në të ardhmen: i) dendësia e madhe e popullatës, ii) resurset e kufizuara ujore, iii) resurset gjithnjë e më të vogla të tokës bujqësore për frymë dhe iv) cilësia e linjitit.

i) Dendësia e popullatës

Dendësia e popullatës është shumë e madhe, mesatarisht në një kilometër katror jetojnë mbi 200 banorë, çka bën që Kosova të jetë ndër vendet më të populluara në Evropë. Marrë parasysh të dhënë se gati gjysma e territorit të Kosovës përbëhet nga viset e pabanuara malore, dendësia reale e popullatës është dy herë më e madhe se kjo – mbi 400 banorë në 1km². Mirëpo, përqendrimi i popullatës në zonën e ndikimit të termocentraleve është më i madh se mesatarja kosovare, kështu që dendësia reale në zonën e ndikimit të drejtpërdrejtë njehson mbi 500 banorë në 1km², çka e përkeqëson dukshëm situatën lidhur me shëndetin e popullatës të ndikuar nga ndotja që vjen nga mihjet dhe termocentralet. Kështu, dëmet që shkaktohen nga ndotja janë shumëfish më të mëdha sesa në vendet e tjera ku janë instaluar kapacitete të njëjta apo më të fuqishme energjetike. Po ashtu, afërsia me Prishtinën, e cila gjendet vetëm 5km larg kësaj zone dhe ku jetojnë mbi 300.000 banorë, bën që problemi i ndotjes të jetë edhe më alarmues. Çdo krahasim me objekte të njëjta në vende tjera të botës është jo real, sepse efektet e ndotësve të ajrit, ujit, dhe tokës në këto vende godasin një numër shumë më të vogël banorësh, duke shkaktuar dëme shumë më të vogla krahasuar me ne. Kështu, sipas të dhënave në dispozicion, dendësia përreth kompleksit të termocentraleve të ndërtuar rreth 18km larg Aachen-it në Gjermani është rreth 200 banorë në 1km². E ngjashme është situata edhe me termocentralin afër Megalopolis-it në Greqi, ku dendësia e popullatës përreth termocentralit është rreth 50 banorë në 1km².

ii) Resurset e kufizuara ujore

Në zonën e ndikimit të termocentraleve, atyre ekzistuese dhe atyre që do të ndërtohen, që është me një sipërfaqe prej afër 1.000km², gjenden burime të pakta të ujërave sipërfaqësore. E tërë zona përshkohet vetëm nga një sistem lumenjsh – nga sistemi Sitnicë-Ibër, dhe gati i tërë potenciali ujor që përdoret nga popullata, industria dhe bujqësia është i përqendruar në vetëm një liqe artificial – atë të Ujmanit. Të gjitha dokumentet e ekonomisë ujore të punuara më parë²³ tregojnë një deficit të theksuar të ujërave në pjesën më të madhe të rrafshit të Kosovës, sidomos në zonën ku gjendet linjiti dhe objektet termoenergjetike, dhe se ardhmëria e këtij sektori dhe sektorëve të tjerë ekonomikë, si bujqësia dhe industria, varet në pjesë të madhe nga in-

23 Institut Jaroslav Cerni: Vodoprivredna osnova Kosova, Beograd, 1983.

vestimet që duhen bërë për ta sjellë ujin nga rrjedhat ujore të rrafshit të Dukagjinit dhe nga sistemi i lumit Lepenc.

Pas vitit 2020, në Kosovë do të ketë një deficit të theksuar të ujërave që nuk mund të mbulohet as me bartjen e ujit nga rrafshi i Dukagjinit.²⁴ Disa studime²⁵ parashohin një rritje të përshkallëzuar të nevojës për ujëra në deceniet e ardhshme, si rezultat i veprimt të ndërsjellë të disa faktorëve: shtimit demografik, nevojave të shtuara për industri dhe energjetikë, nevojës për rritje të prodhimit bujqësor me anë të ujitjes së sipërfaqeve bujqësore të një cilësie të lartë, etj.

(iii) Resurset gjithnjë e më të vogla të tokës bujqësore

Përkundër faktit se Kosova ka sipërfaqe të vogël të territorit dhe dendësi të madhe të popullatës, edhe më tej vazhdohet me shfrytëzimin dhe menaxhimin pa përgjegjësi të sipërfaqeve bujqësore, sidomos atyre që gjenden në pjesën rrafshinore të saj. Sot kanë ngelur vetëm 380.000ha tokë punuese dhe livadhe, prej të cilave 70.000ha janë pak të përdorshme, për shkak se bëjnë pjesë në klasat VI-VIII të bonitetit. Kështu, Kosova aktualisht radhitet në vendet me sasinë më të vogël të tokës punuese për kokë banori, prej gjithsej 0,15ha. Me trendin e tanishëm të shtimit natyror të popullatës, varfëria me tokë për kokë banori gjithnjë do të rritet. Marrë parasysh këtë, shtrohet domosdoja që të luftohet për rruajtje të çdo metri katror të këtij resursi tejet të rëndësishëm - tokës, pasi që zvogëlimi i këtij resursi natyror, së bashku me ujin, po bëhet gjithnjë më tepër faktor kufizues zhvillimorë.

iii) Cilësia e linjtit

Ndonëse linjiti si resurs nuk paraqet vetvetiu faktor limitues zhvillimor, disa nga veçoritë e tij bëjnë që kufizimet e përmendura më lartë të jenë edhe më të shprehura. Deri para disa dekenieve, linjiti nuk është konsideruar fare të jetë thëngjill, në kuptim të lëndës djegëse komerciale. Si të tillë janë konsideruar vetëm thëngjillguri dhe thëngjilli i murmë. Sot, një pjesë e madhe e vendeve e përdor linjitin si burim të vetëm energjetik. Mirëpo, përbërja e lartë e lagështisë dhe e hirit, aftësia e ulët termike, transporti i vështirësuar, nevoja për hapësirë të madhe për ta deponuar hirin si dhe gropat e mëdha që hapen pas mihjes së tij, e bënë linjitin energjent shumë të papërshtatshëm për përdorim. Për të fituar energji të mjaftueshme, duhet të djegim sasi enorme të tij, gjë që gjeneron probleme të shumta, në rast të parë mjedisore, sociale dhe okupon hapësirë enorme. Në veçanti, linjiti i Kosovës karakterizohet me përbërje të lartë të hirit krahasuar me linjitin e disa vendeve tjera, kështu që për ta deponuar duhet të degradohen hapësira shumë të mëdha të sipërfaqeve bujqësore.

24 Shqyrtimi multidisiplinor i mundësive zhvillimore të Kosovës, Prishtinë 1996; Koriscenje, degradacija i zasita vodnih resursa na području REIS Kosova, Energoprojekt, Beograd, 1989.

25 Institut Jaroslav Cerni, Vodoprivredna osnova Srbije, 1997.

Çështja e gjashtë: Sa ka ajër në tymin që thithim?

ktualisht termocentralet Kosova A dhe B janë ndotës enormë të ajrit, sidomos në pikëpamje të pluhurit që emitohet nga këto termocentrale. Niveli i emisionit të pluhurit nga tymtarët e termocentralit Kosova A është 40 herë më i lartë, përkatësisht 4000% më i lartë, sesa që është përqendrimi maksimal i lejuar me rregullativat e BE-së, ndërsa ai i emisionit nga Kosova B është 1000% më i lartë. Meqenëse këto dy termocentrale do të vazhdojnë punën edhe një kohë të gjatë, rreth 700.000 qytetarë që jetojnë në një zonë të ngushtë ndikimi të tyre do të vazhdojnë të thithin shumë tym, me pak ajër në të. Situata përkeqësohet dukshëm, e me të edhe shëndeti i popullatës, kur të kihet parasysh edhe fakti se përqendrimet e dyoksidit të sulfurit, oksideve të azotit, si dhe monoksidit të karbonit janë në të shumtën e rasteve ekscesive dhe standardeve të BE-së. Pavarësisht nga teknologjitë e reja dhe ndotja më e ulët që do të shkaktohet nga Kosova C të shikuar si termocentrale të vetme (të izoluar), situata e përgjithshme me cilësinë e ajrit do të përkeqësohet edhe më tej me ndërtimin e saj.

Çështja e gjashtë – Sa ka ajër në tymin që thithim?

Aktualisht termocentralet Kosova A dhe B janë ndotës enormë të ajrit, sidomos në pikëpamje të pluhurit që emitohet nga këto termocentrale. Niveli i emisionit të pluhurit nga tymtarët e termocentralit Kosova A është 40 herë më i lartë, përkatësisht 4000% më i lartë, sesa që është përqendrimi maksimal i lejuar me rregullativat e BE-së,²⁶ ndërsa ai i emisionit nga Kosova B është 1000% më i lartë. Megjithatë këto dy termocentrale do të vazhdojnë punën edhe një kohë të gjatë²⁷, rreth 700.000 qytetarë që jetojnë në një zonë të ngushtë ndikimi të tyre do të vazhdojnë të thithin shumë tym, me pak ajër në të. Situata përkeqësohet dukshëm, e me të edhe shëndeti i popullatës, kur të kihet parasysh edhe fakti se përqendrimet e dyoksidit të sulfurit, oksideve të azotit, si dhe monoksidit të karbonit janë në të shumtën e rasteve ekscesive dhe standardeve të BE-së.²⁸ Pavarësisht nga teknologjitë e reja dhe ndotja më e ulët që do të shkaktohet nga Kosova C të shikuar si termocentrale të vetme (të izoluar), situata e përgjithshme me cilësinë e ajrit do të përkeqësohet edhe më tej me ndërtimin e saj.

Ndonëse shëndeti i njeriut varet nga përqendrimet e ndotësve të ndryshëm në ajër, përkatësisht nga cilësia e ajrit, çuditërisht ende nuk ka të dhëna të cilat mund të konsiderohen tregues të sigurt për cilësinë e ajrit përreth termocentraleve. Kjo për arsye se shpërndarja në hapësirë dhe kohë e ndotësve të gjeneruar në termocentrale varet nga shumë faktorë: regjimi i punës së termocentralit, kahu i rrymimit të ajrit, lartësia e tymtarit, kushtet hidrometeorologjike, distanca nga tymtarët etj. Deri tani asnjëherë nuk janë bërë matjet e cilësisë së ajrit ashtu që të merren parasysh të gjithë këta faktorë.

Megjithatë, niveli i përgjithshëm i ndotjes së ajrit, përkatësisht cilësia e tij, mund të vlerësohen nga matjet e ndryshme që janë realizuar deri tani lidhur me emisionet nga termocentralet. Në përgjithësi, të dhënat në dispozicion për emisionet e pluhurit, dyoksidit të sulfurit dhe oksideve të azotit tregojnë nivel shumë të lartë të ndotjes, me ç'rast termocentrali Kosova A na del ndotës shumë më i madh sesa termocentrali Kosova B. Nga ana tjetër, edhe sikur të përjashtohet shkalla e ndotjes e shkaktuar nga termocentrali A, niveli i emisionit të këtyre ndotësve nga termocentrali Kosova B tregohet të jetë shumëfish më i lartë se sa që janë normat e lejuara sipas standardeve të Bashkësisë Evropiane. Në vijim janë dhënë disa të dhëna për emisionet e këtyre ndotësve.

1) Pluhuri

Matjet e pluhurit të emituar nga blloku B1 i termocentralit Kosova B, të realizuara në tetor të vitit 2005 nga ana e kompanisë **Electrowatt Ekono**, kanë shënuar vlera 526-577mg/Nm³, për kushtet standarde, gazrat e thata dhe 6% O₂.²⁹ Kjo do të thotë se përqendrimi i emisionit të pluhurit nga blloku B1 është mbi dhjetë herë më i lartë sesa që është vlera kufizuese e BE-së (50mg/ Nm³). Vlera mjaft të larta janë shënuar edhe me matjet e realizuara në vitin 1994 nga ana e institutit INKOS.³⁰ Siç është theksuar edhe më lart, së bashku me emetimin nga termocentrali Kosova A, emisioni i matur i pluhurit është me disa dhjetëra herë më i lartë sesa i lejuari sipas standardeve evropiane. Pluhuri nuk emitohet vetëm nga tymtarët, por edhe gjatë trajtimit dhe

26 Large Combustion Plants LCP Directive 2001/80/EC dhe rekomandimet e EC 2003/47/EC.

27 Rehabilitimi i termocentralit Kosova A parashihet të përfundojë në vitin 2008-2009 (blloqet 4 dhe 5). Ato do të operojnë edhe 11-13 vjet pas rehabilitimit teknik të tyre. Të tri termocentralet (Kosova A, Kosova B dhe Kosova C) do të operojnë deri në vitin 2021-2022. Të shikohet po ashtu: MEM, Broshura për TC të reja, MEM, 3 maj 2006.

28 Large Combustion Plants LCP Directive 2001/80/EC dhe rekomandimet e EC 2003/47/EC.

29 Pre-feasibility Study for Pollution Mitigation Measures at Kosovo B Power Plant, Electrowatt Ekono, February 2006.

30 INKOS, Studimi për përcaktimin e ndotjes së mjedisit nga objektet energjetike të KEK-ut, 1994.

transportit të tij nga kazanët deri në deponitë e hirit. Në këtë mënyrë, rreth 70.000t pluhur emitohen në ajër çdo vit, ose rreth 200t në ditë – shiko kornizën 4.

Korniza 4. Trajtimi, transporti dhe deponimi i hirit⁴

Problemet e pluhurit të shkaktuara nga hiri fillojnë që nga kazanët e avullit, ku janë gjetur sasi të mëdha të hirit për shkak se nga pluhurizuesit, fundërruesit dhe nyjet e gypave rrjedhin sasi të mëdha të hirit si në brendi ashtu edhe mbi tokë jashtë ndërtesave të kazanëve të avullit. a së gjithash ky është një problem shëndetësor për punëtorët, por kur hiri zhvendoset mekanikisht dhe transportohet në deponi, atëherë ky bëhet po ashtu edhe problem i jashtëm.

Hiri i mbledhur transportohet me metodë të tharë në silosin për deponim të përkohshëm, prej ku transportohet si suspension me anë të një gypi deri në deponinë përkatëse. Transporti i hirit të lagësht në formë suspensioni nuk shkakton probleme me pluhur, por gjatë rrugës nga impianti deri në deponi humben sasi të mëdha, kështu që dhe kur hapësira e deponisë thahet atëherë formohet pluhuri në hapësirën përreth.

... sipas një vlerësimi, trajtimi dhe transporti i hirit shkaktojnë rreth 19.500 tonë, kurse hapësirat e deponisë rreth 50.000 tonë emetimesh vjetore të pluhurit.

2) Dyoksidi i sulfurit (SO₂)

Matjet e dyoksidit të sulfurit të emetuar në ajër nga tyntari i termocentralit B, të realizuara nga instituti INKOS në vitin 1994, kanë regjistruar përqendrim prej 816 mg/Nm³ të këtij gazi, për kushtet standarde, gazrat e thata dhe 6% O₂. Vlera përafërsisht të njëjta janë përfutur edhe nga llogaritjet e kompanisë Carl Bro të bëra në vitin 2002.³¹ Sipas kësaj kompanie, përqendrimi i pluhurit të emituar nga blloqet e termocentralit Kosova B njehson 894mg/Nm³, për një bllok. Vlera e tillë është njehsuar në bazë të përmbajtjes së sulfurit prej 1% dhe desulfurimit prej 77,5% të shkaktuar nga prania e kalciumit në formë të kompozimit CaO në linjtin e shfrytëzuar. Këto të dhëna tregojnë se përqendrimi i emisionit të dyoksidit të sulfurit nga termocentrali Kosova B është rreth dy herë më i lartë sesa që është vlera kufizuese mujore e BE-së (400mg/ Nm³)

3) Oksidet e azotit (NO_x)

Edhe përqendrimet e oksideve të emetuara të azotit nga tyntari i Kosovës B janë shumë më të larta sesa që janë vlerat e lejuara sipas normave të BE-së. Përqendrimi i matur nga instituti INKOS në vitin 1994 ka njehsuar 1.056mg/Nm³ të këtyre gazrave, për kushtet standarde, gazrat e thata dhe 6% O₂.

Në bazë të përmbajtjes mesatare të azotit në linjtin e Kosovës dhe veçorive teknike të procesit të djegies në termocentral, emisionet e llogaritura të NO_x nga tyntarët e termocentralit B sipas kompanisë Carl Bro njehsojnë 735 mg/Nm³. Nga ana tjetër, matjet e këtyre gazrave të emituar nga blloku B1 i termocentralit B, të realizuara në tetor të vitit 2005 nga ana e kompanisë **Electrowatt Ekono** kanë shënuar vlera 661-713 mg/Nm³, për kushtet standarde, gazrat e thata dhe 6% O₂.

³¹ Carl Bro Group, Environmental Impact Assessment and Action Plan for Kosovo A and B Power Plants and Coal Mines. Environmental Action Plan, June 2003.



Figura 2. Ajri të cilin e thithim nga termocentralet kosovare

Marrë parasysh të dhënën se vlera maksimale e lejuar sipas normave të BE-së është 735 mg/Nm^3 , kjo do të thotë se emisioni i oksideve të azotit është 50-100% më i lartë se i lejuari. Pas vitit 2016 vlera kufizuese e emisionit sipas normave të BE-së do të jetë 200 mg/Nm^3 çka do të thotë se atëherë ky emision do të jetë 300-500% më i lartë se i lejuari. Është e qartë se po të merret parasysh edhe ndotja e cila shkaktohet nga termocentrali A situata është shumë më alarmante.

Këto të dhëna janë indikatorë të mjaftueshëm për të treguar se me planet për ndërtim të termocentralit të ri me fuqi 2.100MW problemet mjedisore vetëm sa do të ashpërsohen, edhe pas ndërprerjes së punës së termocentralit Kosova A. Janë dy arsye për këtë:

i) Kapacitetet e instaluar të termocentraleve të reja do të jenë shumëfish më të larta sesa që janë kapacitetet e termocentraleve ekzistuese, çka do të do të kërkojë shumë më tepër linjit për të djegur dhe, pavarësisht nga efikasiteti më i lartë i tyre në zvogëlimin e emisionit të ndotësve krahasuar me termocentralet ekzistues, sasia e ndotësve të emituar në ajër do të jetë e konsiderueshme.

ii) Zgjidhja e lokacionit që propozohet për ndërtimin e termocentraleve të reja do t'i kontribuojë në masë të madhe përkeqësimit të gjendjes së mjedisit në hapësirën e gjerë përreth termocentraleve dhe mihjeve ekzistuese. Sipas planit të tanishëm, termocentrali i ri do të ndërtohet afër termocentralit Kosova B, kështu që praktikisht të gjitha termocentralet do të jenë të rreshtuara njëri pas tjetrit në të ardhmen. Në këtë mënyrë, ndotësit e dalë nga tymtarët do të bashkohen shpejt në ajër, duke e ngritur përqendrimin e tërësishëm të tyre. Qytetarët e Prishtinës, pra, në një të ardhme të afërt nuk do ta thithin vetëm tymin që del nga termocentrali Kosova B, siç u theksua më lartë të ndotur mbi normat e lejuara, por edhe të termocentralit Kosova C, që pa evitueshëm do të emitojë po ashtu gazra të ndotur dhe do ta përkeqësojë cilësinë e ajrit tanimë alarmante.

Çështje në vete paraqet emisioni i dyoksidit të karbonit (CO_2) nga termocentralet. Ndonëse emisioni i këtij gazi nuk ka efekt të dëmshëm të drejtpërdrejtë në shëndetin e njeriut dhe të mjedisit në kuptim të ngushtë, ndikimi i tij nëpërmjet efektit të serës në ngrohjen globale është gjithnjë e më i pranishëm.

Sasia e emetuar e dyoksidit të karbonit është proporcionale me përmbajtjen e karbonit në karburant dhe me sasinë e linjtit të djegur. Sipas disa të dhënave,³² në vitin 2005 me djegien e linjtit në termocentralet Kosova A dhe Kosova B janë emetuar rreth 5,8 milion tonë CO₂, me ç'rast vetëm nga Kosova B janë emetuar 4,5 milionë tonë. (Vlerësimet e kompanisë Carl Gro Group për vitin 2002 kanë qenë rreth 8,9 milion tonë.³³) Marrë parasysh këto të dhëna, duke supozuar emision të njëjtë të dyoksidit të karbonit për 1MW fuqi, pas mbylljes së termocentralit Kosova A dhe fillimit të punës së termocentralit Kosova C nga termocentralet kosovare do të emetohen rreth 22,5 milionë tonë CO₂, ose rreth 16,8 milionë tonë më shumë se në vitin 2005.

Duhet theksuar se nuk ekziston ndonjë metodë komerciale për largim të CO₂ nga gazrat e tymtarëve të termocentraleve. Opsioni më i mirë për zvogëlimin e emisionit të këtij gazi për 1MW fuqi të prodhuar është që të përmirësohet efikasiteti i djegies në termocentrale, mirëpo edhe kjo mundësi i ka kufizimet e veta.

Të vetëdijesuar për efektet tejet negative globale të gazrave të serës, ku bën pjesë edhe dyoksidi i karbonit, një numër shumë i madh shtetesh janë dakorduar që të zvogëlojnë këtë emision dhe për këtë qëllim e kanë nënshkruar Protokollin e Kyoto-së – shiko kornizën 4. Marrë parasysh kushtet shumë rigoroze të parapara për mospërmbushje të obligimeve ndaj këtij protokolli, Kosova do të gjendet në një situatë shumë të vështirë në të ardhmen me ndërtimin e termocentraleve të reja me kapacitet 2.100MW. Për shkak të emisionit të dyoksidit të karbonit nga ky termocentral do duhet bërë shpenzime të mëdha financiare për të blerë tejkalinin e sasive të emetuara. Kështu, po qe se merret për bazë sasia e sipërpërmendur prej 16,8 milionë tonë e dyoksidit të emetuar në tepriçë, shuma që do duhet paguar për kompensim do të jetë rreth 84 milion Euro në vit, me çmim kompensimi 5 Euro për 1t CO₂. Nga ana tjetër, edhe nëse kjo shumë do të kompensohej nga investitorët e huaj, këto rrethana do të ndikojnë konsiderueshëm në frenimin e çfarëdo zhvillimi vetjak industrial, pasi që për çdo gram të emetuar të këtyre gazrave Kosova duhet të ndajë mjete të konsiderueshme financiare.

32 TIAM, Raporti vjetor, Divizioni i gjenerimit të energjisë elektrike, 2005.

33 Carl Bro Group, Environmental Impact Assessment and Action Plan for Kosovo A and B Power Plants and Coal Mines. Environmental Action Plan, June 2003.

Korniza 5. Protokolli i Kyoto-së

Protokolli i Kyoto-së paraqet njërin nga dokumentet e rëndësishëm të cilët janë aprovuar pas Samitit të Rio-së kushtuar problemeve globale klimatike, të mbajtur në vitin 1992, kur është aprovuar Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike UNFCCC (United Nation Framework Convention on Climate Change). Qëllimi kryesor i Konventës është arritja e “stabilizimit të përqendrimeve të gazrave me efekt të serës⁵ në nivel i cili nuk do të ndikojë në ndryshimet e mëtejme të ndjeshme klimatike.⁶

Vetë Protokolli është aprovuar më 11 dhjetor 1997 në Konferencën e tretë të palëve të UNFCCC-së të mbajtur në Kyoto të Japonisë. Protokolli ka hyre në fuqi vetëm më 12 shkurt 2005 pas nënshkrimit të Rusisë, ngase si kusht për hyrje në fuqi ishte që Protokolli të ratifikohet nga më së paku 55% të palëve nënshkruese të Konventës UNFCCC.⁷ Palët nënshkruese të protokollit janë zotuar që gjatë fazës së parë të zbatimit, përkatësisht brenda periudhës 2008-2012, të zvogëlojnë për së paku 5% sasinë e emetuar të gazrave të serës krahasuar me vitin 1990.⁸ Mospërmbushja e obligimeve nga Protokolli ka për pasojë penale të mëdha për vendet që për çfarëdo arsye nuk arrijnë t'i përmbushin zotimet. Njëri prej mundësive të kompensimit të mospërmbushjes është që sasia e papërmbushur të blihet nga ndonjë vend që ka arritur ta realizojë zvogëlimin në përqindje më të madhe sesa që është zotuar. Në rastet e tilla çmimi për 1t të këtyre gazrave ka qenë deri vonë 5-10 Euro. Në disa raste vlera ka njehsuar edhe 30 Euro për 1t.

Çështja e Shtatë:

A duhet Sitnica të jetë kolektor i ujërave të ndotura?

Ndotja e lumenjve në Kosovë karakterizohet me efekte të shumta negative. Krahës mungesës së përgjithshme të ujërave dhe pakësimit të konsiderueshëm të tyre gjatë fundit të verës dhe fillimit të vjeshtës, Kosova karakterizohet edhe me një shpërndarje shumë të pafavorshme regjionale të resurseve ujore ekzistuese, në rend të parë të lumenjve. Në Kosovën qendrore, ku janë të vendosura mbi 80% të kapaciteteve të saja industriale, rrjedha specifike e lumenjve është 2-4 l/s në 1km², duke u radhitur kështu ndër regjionet më të varfra me ujë në Ballkan. Nga ana tjetër, buzë maleve të Sharit dhe Bjeshkëve të Nemuna rrjedha e ujit është 15 herë më e madhe sesa në Kosovën qendrore. Në këto rrethana, mbajtja e cilësisë së ujit të lumit Sitnicë, si i vetmi lumë ku derdhet sistemi i lumenjve që qarkullojnë në zonën e gjerë të ndikimit të termocentraleve, është me interes vital për Kosovën.

Çështja e shtatë: A duhet Sitnica të jetë kolektor i ujërave të ndotura?

Ndotja e lumenjve në Kosovë karakterizohet me efekte të shumta negative. Krahas mungesës së përgjithshme të ujërave dhe pakësimit të konsiderueshëm të tyre gjatë fundit të verës dhe fillimit të vjeshtës, Kosova karakterizohet edhe me një shpërndarje shumë të pafavorshme regjionale të resurseve ujore ekzistuese, në rend të parë të lumenjve. Në Kosovën qendrore, ku janë të vendosura mbi 80% të kapaciteteve të saja industriale, rrjedha specifike e lumenjve është 2-4 l/s në 1km², duke u radhitur kështu ndër regionet më të varfra me ujë në Ballkan. Nga ana tjetër, buzë maleve të Sharit dhe Bjeshkëve të Nemuna rrjedha e ujit është 15 herë më e madhe sesa në Kosovën qendrore.³⁴ Në këto rrethana, mbajtja e cilësisë së ujit të lumit Sitnicë, si i vetmi lumë ku derdhet sistemi i lumenjve që qarkullojnë në zonën e gjerë të ndikimit të termocentraleve, është me interes vital për Kosovën.

Baseni i Kosovës, ku gjenden rezervat më të mëdha të linjitet të Kosovës, përbëhet nga një rrafshinë e kufizuar me kodra dhe male përreth. Ky basen përshkohet me një rrjet hidrologjik të rrjedhave të lumenjve më të vegjël që derdhen në lumin Sitnicë, që paraqet arterien kryesore ujore të këtij baseni. Sitnica shtrihet prej jugut në veri të basenit, duke bartur rreth 80% të ujit të mbledhur në drejtim të veriut.³⁵ (Lumenjtë tjerë që derdhen në Sitnicë në afërsi të termocentraleve janë lumi Drenicë në perëndim dhe lumi Llap në lindje.) Rrjedhja e lumit Sitnicë ndryshon shumë brenda vitit – prej rrjedhës minimale 0,5–1,5m³/s deri në atë maksimale 50-120m³/s, me rrjedhë mesatare vjetore 10m³/s.³⁶ Në këtë mënyrë, brenda një periudhe të konsiderueshme të vitit rrjedha e ujit është shumë e vogël për ta “përballë” tërë ndotjen e cila “i dhurohet” këtij lumi.

Ndotja enorme e Sitnicës nga objektet e mëdha energjetike (termocentraleve Kosova A dhe B), objektet tjera industriale përgjatë tij (Trepça dhe Ferronikeli) dhe nga ujërat e zeza urbane të shumë vendbanimeve që gjenden në luginën ku rrjedh sistemi përkatës i lumenjve,³⁷ bën që ky lum praktikisht të rezultojë në një kolektor të hapur të ujërave ndotura. Ujërat e ndotura që do të gjenerohen si pasojë e ndërtimit të termocentralit Kosova C dhe hapjes së minierës së re nuk kanë ku tjetër të derdhen përpos në këtë lum, gjë që do ta përkeqësojë edhe më tej cilësinë e tij.

Ndonëse uji i Sitnicës është i ndotur edhe para se të derdhen në të rrjedhat ujore nga termocentralet ekzistuese, ujërat e shkarkuara nga termocentralet dhe mihjet ekzistuese të linjitet e përkeqësojnë edhe më tej cilësinë e tij, sidomos në pikëpamje të krupërave të sulfatit, materieve të suspenduara të ngurta dhe fenolëve. Përqendrimet e substancave të ndryshme të përmbajtura në ujërat shkarkuese nga dy minierat ekzistuese, të formuara me kullimin e ujërave nga minierat, janë shumë të mëdha dhe bëjnë që përqendrimet e tyre në Sitnicë, pasi të derdhen në të, të tejkalojnë vlerat maksimale të lejuara. Është e qartë se me hapjen e minierës së re në Fushën e Sibovcit, me kapacitet mihjeje shumë më të madh sesa që është i tanishmi, shkalla e ndotjes së Sitnicës do të rritet edhe më shumë. Duhet theksuar se edhe vetë termocentrali i ri Kosova C me kapacitet 2.100MW do të gjenerojë ndotje. Që tani në Sitnicë derdhen rreth 0,47 m³/s ujëra nga repartet e ndryshme

34 R. Pllana, Hidrologjia, gjendja e tanishme, perspektiva e shfrytëzimit dhe e ruajtjes së resurseve ujore, Prishtinë, 1996, Shqyrtimi multidisiplinor i mundësive zhvillimore të Kosovës.

35 Sitnica është lumë i terrenit rrafshinor, pa shtrat të formuar dhe stabil, me vërshime të shpeshta dhe me pamundësi për të krijuar akumulime ujore. Në rastet e vërshimit, Sitnica mund të përmbysë rreth 12.000ha tokë.

36 Raportet për vitet 2001- 2003 të Sektorit për Mjedis në kuadër të INKOS-it.

37 L. Shllaku, Sitnica kolektor i hapur i ujërave efluent, Simpozium shkencor, Vode 1994, Beograd, 1994.

të kompleksit të termocentraleve ekzistuese,³⁸ kurse me ndërtimin e termocentralit të ri do të derdhet në të së paku po e njëjta sasi e ujërave, me ndotës të ndryshëm të përmbajtur në të. Kështu, ekziston rreziku real që brenda muajve me rrjedha të vogla të ujit, ndotja e cila do t'i bëhet Sitnicës nga termocentralet dhe mihjet e linjitet të pamundësojë zhvillimin e gjallesave në të. Kjo është treguar edhe me matjet të bëra në kohën kur termocentralet ekzistuese kanë punuar me kapacitet pothuajse të plotë, kur është konstatuar se gjatë muajve kritikë uji në Sitnicë, pasi që në të derdhen ujërat nga kompleksi i termocentraleve, nuk përmban gati aspak oksigjen të nevojshëm për mbijetesën e gjallesave.³⁹



Figura 3. Ujërat nga mihja në Bardh të cilat derdhen në lumin Drenicë

Ndotja e ujërave shkaktohet edhe nga hiri i termocentraleve, pasi që gjatë periudhave kohore me shi vjen deri te tretja e komponimeve të ndryshme të përmbajtura në të, përveç tjerash edhe i derivateve të fenolit. Kalimi i këtyre komponimeve në brendi të tokës shkakton ndotjen e ujërave nëntokësore, të cilat atë tokë e bëjnë të rrezikshme për njerëzit, bimët dhe kafshët, kështu që ato bëhen të pashfrytëzueshme. Përdorimi eventual i këtyre ujërave nëntokësore për nevoja të njerëzve mund të shkaktojë helmime të rrezikshme, por edhe sëmundje të kancerit.

38 Sipas vlerësimeve të kompanisë Carl Gro Group, nga gjithsej 25.400.000 m³ për nevoja të termocentraleve ekzistuese, rreth 11.000.000 m³ avullohen, rreth 15.000.000 m³ shkarkohen në Sitnicë, me ose pa trajtim të ujërave të ndotura, kurse rreth 410.000 m³ infiltrohen në ujërat nëntokësore. Burimi: Carl Bro Group, Environmental Impact Assessment and Action Plan for Kosovo A and B Power Plants and Coal Mines. Environmental Action Plan, June 2003.

39 E. Beqiri et al., Mathematical model for the selfpurification capacity of Sitnica river, VII International Conference: Chemistry for Protection of the Environment, Lublin (Poland), 1989.

Çështja e tetë:

A duhet degraduar tokën bujqësore me çdo kusht?

Toka bujqësore paraqet resursin natyror për të cilin shoqëria kosovare nuk është duke u kujdesur pothuajse fare. As MEM-i nuk bën përjashtim në këtë pikëpamje me planet aktuale për hapjen e minierës së re në Fushën e Sibovcit dhe ndërtimin e termocentralit të ri Kosova C. Janë të shumta abuzimet të cilat mund të bëhen me toka të planifikuara për hapje të minierave, tokat përreth minierave dhe tokat për ndërtim të termocentraleve. Asgjë nga kjo çështje nuk preket me propagandën e tanishme të MEM-it, përkundët faktit se ato do të zihen dhe shndërrohen në gropa të mëdha, do të ndoten nga pluhuri që del nga tymtarët dhe do të tjetërsohet shfrytëzimi i tyre.

Çështja e tetë: A duhet degraduar tokën bujqësore me çdo kusht?

Toka bujqësore paraqet resursin natyror për të cilin shoqëria kosovare nuk është duke u kujdesur pothuajse fare. As MEM-i nuk bën përfshirje në këtë pikëpamje me planet aktuale për hapjen e minierës së re në Fushën e Sibovcit dhe ndërtimin e termocentralit të ri Kosova C.

Janë të shumta abuzimet të cilat mund të bëhen me toka të planifikuara për hapje të minierave, tokat përreth minierave dhe tokat për ndërtim të termocentraleve. Asgjë nga kjo çështje nuk preket me propagandën e tanishme të MEM-it, përkundët faktit se ato do të zihen dhe shndërrohen në gropa të mëdha, do të ndoten nga pluhuri që del nga tymtarët dhe do të tjetërsohet shfrytëzimi i tyre.



Figura 4. Pamje nga deponitë e hirit të termocentralit Kosova A

Mihjet sipërfaqësore karakterizohen me shfrytëzim të sipërfaqeve të mëdha të tokës për ushtrimin e veprimtarisë minerare, gjë që shkakton degradimin e plotë ose të përkohshëm të tokave bujqësore. Për qëllime të realizimit të projektit 'Kosova C - 2.100 MW' sipërfaqe të konsiderueshme të tokës bujqësore do të zihen me: i) hapjen e minierës së re në Fushën e Sibovcit dhe palosjen e shtresës së zbuluar, ii) formimin e deponive për vendosje të hirit që del pas djegies së linjitit në termocentrale, iii) vendosjen e shiritave për transportimin e linjitit dhe të hirit, iv) ndërtimin e objekteve të kompleksit të termocentralit të ri dhe v) gropat e mbetura pas mihjes së linjitit. Ato do të ndoten vazhdimisht, me shtrirje të gjerë përreth, nga pluhuri që del nga tymtarët si dhe nga deponitë përkatëse të hirit. Sipërfaqet e ndotura mund të arrijnë deri në 15% të territorit të përgjithshëm të Kosovës. Tokat përreth po ashtu mund të ndërrojnë funksionin duke u tjetërsuar nga shfrytëzimi bujqësor.

Korniza 6. Kosova tanimë është e varfër me tokë bujqësore për kokë banori

Nga 1.090.000ha, sa është e gjithë sipërfaqja e territorit të Kosovës, sipërfaqe të klasave të bonitetit I-V janë rreth 455.000ha, ose 42% të territorit të përgjithshëm, derisa të klasave VI-VIII janë 635.000ha ose 58%.

Nga shfrytëzimi dhe menaxhimi jo i drejtë i sipërfaqeve bujqësore, sidomos i pjesës rrafshinore të tokës, sot kanë ngelur vetëm rreth 380.000ha të tokës së punueshme dhe livadhe, prej të cilave rreth 70.000ha tanimë i takojnë klasave VI-VIII të bonitetit. Kështu, Kosova tani radhitet ndër vendet me varfëri të madhe të tokës së punueshme për kokë banori - gjithsej 0,15ha. Me shtimin e popullatës, kjo varfëri do të jetë edhe më e theksuar, gjë që duhet që tani të jetë çështje alarmante për politikëbërësit kosovarë, përkatësisht që të ruhet çdo pëllëmbë e tokës bujqësore nga përdorimi për nevoja jo bujqësore apo degradimi i tyre.

1) Sipërfaqet e humbura dhe që do të humben për nevoja bujqësore

Me hapjen e mihjeve të gjertanishme sipërfaqësore toka në Mirash, Dardhishtë dhe Hade është zënë në tri forma: i) me largimin e shtresës pjellore dhe palosjes së saj në sipërfaqe tjera, ii) me vetë mihjet për eksploati-min e thëngjillit dhe iii) me deponimin e hirit, ndërtimin e objekteve të termocentraleve, objekteve transportuese (shiritave), largpërçuesve, objekteve përcjellëse dhe të atyre administrative. Kështu, tokat e degraduara nga djerrinat kapin një sipërfaqe rreth 1.559ha, ndërsa sipërfaqja që përfshijnë fushëgropat e minierave është rreth 1.470 ha, që do të thotë se për aktivitetet minerare tanimë janë degraduar rreth 3.000ha të tokës bujqësore.⁴⁰ Për minierën e re në Fushën e Sibovcit parashikohet zënia e sipërfaqeve të reja - rreth 3.000ha. Përveç kësaj, me rastin e fillimit të ndërtimit të sistemit të ujitjes në këtë territor (1980/81) është kërkuar të abstenohet nga ndërtimi i rrjetit të sistemit në rreth 2.000ha të sipërfaqeve në afërsi të mihjeve ekzistuese sipërfaqësore, që në mënyrë indirekte janë mbetur të papërdorshme për shfrytëzim bashkëkohor të tokës bujqësore, përkatësisht pa ujitje. Gjatë periudhës 1990-2005 janë zënë në mënyrë direkte ose indirekte nga deponimet e hirit dhe kanë dalë nga përdorimi edhe rreth 600ha tokë të këtij nënsistemi të ujitjes.

2) Sipërfaqet e ndotura dhe që do të ndotën

Vite me radhë tokat bujqësore përreth kompleksit ekzistues të mihjeve sipërfaqësore dhe termocentraleve janë ndotur nga ndikimet e ndryshme. Ndikimet më të mëdha negative janë pasojë e ujërave nëntokësore të ndotura nga kullimi i deponimeve të hirit. Ndikim të konsiderueshëm kanë edhe ujërat e vërshuara të Sitnicës dhe të degëve të saj, me përmbajtje të materieve të ndryshme ndotëse, përfshirë edhe derivatet e fenolit. Mirëpo ndikim afatgjatë negativ kanë shkaktuar edhe fundërrinat e pluhurit të tymtarëve dhe shirat acidike të krijuara nga gazrat e emetuara të djegies së linjtit. Në këtë mënyrë sipërfaqe të mëdha përreth kompleksit të termocentraleve dhe minierave janë bërë po ashtu pothuajse të papërdorshme.

Si pasojë e ndotjes, disa lloje bimësh nuk mund të kultivohen fare më në këtë region. Kështu, bimët e familjes cucurbitaceae (shalqiri, pjepri, kastravec etj.) nuk mund të kultivohen me sukses pasi që pluhuri, hiri

⁴⁰ Raporti mjedisor për vitin 2006, KEK, 2007.

dhe ndotësit tjerë i thajnë ato që në fillet e rritjes së tyre. Ndikimi negativ i ndotjes së bimëve nga ajri, toka dhe ujërat nëntokësore bartet edhe te njerëzit dhe krijesat e tjera të gjalla.

Nga 19 elemente kimike të identifikuar në hi dhe tokë, vetëm 7-8 prej tyre kanë ndikim pozitiv, ndërsa të tjerat kanë ndikim negativ. E tërë kjo ka bërë që shumë bimë pemëtarie, sidomos ato të imëta (dredhëza, mje-dra etj.), kanë dalë tanimë nga prodhimtaria. Edhe bimët lavërtare (gruri, misri, panxhar sheqeri, luledielli, jonxha etj.) dëmtohen në përmasa të mëdha për shkak të mbulimit me pluhur hiri të sipërfaqeve asimiluese të gjetheve të bimëve, duke ndikuar drejtpërdrejt në rendimentet dhe cilësinë e frutave të tyre. Nga ndotja, sidomos ajo e ujërave nëntokësore, kontaminohen edhe bimët frytrrënjore (patatja, qepa, hudhra, panxharët e ndryshëm, karota etj.). Në përmasa të mëdha kontaminohen bimët forazhere, të cilat konsumohen nga kafshët shtëpiake, e përmes tyre ndikimi bartet edhe te njeriu.

Në përgjithësi, gati gjitha prodhimet bujqësore nga ky regjion janë të kontaminuara në një mënyrë dhe nuk janë aspak të sigurta për ushqim të njerëzve dhe kafshëve.

Korniza 7. Deklarata e një bujku nga rrethi i Kastriotit

Në një emision televiziv të RTK-së kushtuar problemeve të popullatës të shkaktuara nga termocentraleve ekzistuese Kosova A dhe B, të emituar gjatë muajit shkurt 2007, një bujk nga këto hapësira deklaroi se është kot të kultivohet toka dhe bagëtia pasi që blerësit potencial sa po kuptojnë se produktet përkatëse kanë origjinë nga Kastrioti dhe rrethina heqin dorë nga blerja e tyre...

E KONOMIKA E PROJEKTIT 'KOSOVA C – 2.100MW' DHE KONFLIKTE ZHVILLIMORE



Çështja e nëntë:

A është projekti 'Kosova C' projekt kombëtar apo ndërkombëtar?

MEM-i tashmë ka dal me të dhëna për përfitimet financiare nga operimi i termocentralit Kosova C, që janë mjaft joshëse për të painformuarit mirë lidhur me brendinë e tyre dhe përfitimet reale që do t'i ketë Kosova. Ofrohen shifra dhe përfitime të mëdha për Kosovën: se do të investohen, ose siç po thuhet nganjëherë do të 'hyjnë' në Kosovë, rreth 3,6 miliardë Euro, se Kosova do të përftojë rreth 150 milionë Euro në vit, se qarkullimi do të jetë 600 milionë Euro në vit, se buxheti i Kosovës do të pasurohet për rreth 60 milionë Euro në vit, se Kosova do të bëhet fuqi energjetike dhe do të eksportojë rrymë elektrike etj. Por e vërteta është shumë prozaike dhe aspak entuziazmuese: eksportues i rrymës do të jetë vetëm investitori i jashtëm, kurse përfitimet e mëdha nuk do t'i takojnë Kosovës por po ashtu investitorit të jashtëm.

EKONOMIKA E PROJEKTIT

'KOSOVA C – 2100MW'

Kosova C nuk mund të ndërtohet pa investime të jashtme. Por, a duhet të bëhet ekskluzivisht me investime të jashtme – pa pjesëmarrje të kapitalit tonë? Në vijim do të elaborohen disa çështje të cilat skenarin ekonomik të projektit 'Kosova C' e nxjerrin si pak ose pothuajse aspak të leverdishëm për Kosovën.

Çështja e nëntë: A është projekti 'Kosova C' projekt kombëtar apo ndërkombëtar?

MEM-i tashmë ka dal me të dhëna për përftimet financiare nga operimi i termocentralit Kosova C, që janë mjaft joshëse për të përfshirur mirë lidhur me brendinë e tyre dhe përftimet reale që do t'i ketë Kosova. Ofrohen shifra dhe përftime të mëdha për Kosovën: se do të investohen, ose siç po thuhet nganjëherë do të 'hyjnë' në Kosovë, rreth 3,6 miliardë Euro, se Kosova do të përftojë rreth 150 milionë Euro në vit, se qarkullimi do të jetë 600 milionë Euro në vit, se buxheti i Kosovës do të pasurohet për rreth 60 milionë Euro në vit, se Kosova do të bëhet fuqi energjetike dhe do të eksportojë rrymë elektrike etj. Por e vërteta është shumë prozaike dhe aspak entuziazmuese: eksportues i rrymës do të jetë vetëm investitori i jashtëm, kurse përftimet e mëdha nuk do t'i takojnë Kosovës por po ashtu investitorit të jashtëm.

i) Qarkullimi që prezantohet se do ta bëjë operatori i jashtëm parashihet të jetë 600 milionë Euro, duke llogaritur çmimin shitës prej 40 Euro/MWh të energjisë elektrike.⁴¹ Në këtë moment ky çmim është shumë më i lartë. Çmimi aktual është 72 Euro/MWh, që e bënë qarkullimin vjetor shumë më të madh sesa ai që jepet në raport. Mjetet e inkasuara nga rritja e çmimit të energjisë, që pritet të vazhdojë në periudhën e ardhshme shumëvjeçare,⁴² do të shkojnë kryesisht në konto të operatorit të jashtëm, kështu që Kosova nuk do të përfitojë, ose më mirë të themi do të ketë leverdi minimale, nga kjo rritje. Një konstatim i tillë konsiston në faktin se përftimet e Kosovës vijnë pothuajse vetëm nga kategoritë fikse (93%), siç është çmimi i shitjes së linjës të rritur me marrëveshje paraprake, qiraja e tokës së zënë, taksat e vjela nga kompanitë vendore dhe nga bartja e energjisë, pagat e punëtorëve. Të gjitha mjetet që do t'i inkason Kosova nga këto kategori nuk do të ndikohen pothuaj aspak nga rritja e çmimit me të cilin operatori i jashtëm do ta shes rrymën. Pra, profiti nga rritja e çmimit të energjisë do t'i mbetet investitorit. Është vetëm një kategori përftimesh ku rritja e çmimit të energjisë sjell rritje proporcionale të përftimeve për Kosovën - tatimi mbi fitimin e korporatës. Mirëpo kjo kategori bënë pjesë me vetëm 7% në përfitimin e paraparë të përgjithshëm që do t'i takon Kosovës.

ii) MEM sjell shumë pak detaje ekonomike-financiare, kështu që të gjitha komentet e bëra në këtë analizë janë të bazuara ekskluzivisht në llogaritjet që janë ofruar gjatë të ashtuquajturave prezantimeve publike të projektit për ndërtim të termocentralit të ri. Kjo lënë hapësirë për dyshime se akoma nuk janë bërë studimet e mirëfillta të skenarëve të mundshëm ekonomikë, që do ta rritnin vlerën e faturës të cilën qeveria do duhej t'ia parashtronte operatorit të termocentralit Kosova C. Para se një faturë e tillë të bëhet, duhet studiuar mirë të gjitha shpenzimet që ndërlidhen me ndërtimin e termocentralit të ri dhe të projektohen saktësisht ato.

41 MEM, Vlerësimi preliminar i ndikimeve ekonomike nga ndërtimi i termocentraleve të reja në Kosovë, shkurt 2006.

42 Gjatë periudhës 2005-2006 çmimi mesatar i energjisë elektrike për 1kWh është rritur nga 8,14\$ në 8,85\$, ose për 10%. Burimi: http://www.cia.dse.gov/cneat/electricity/epm_sum.html

Në këtë kuptim duhen projektuar shpenzimet që do të ndërlidhen me:

- 1) Rehabilitimin, përkatësisht mbushjen dhe kultivimin, e plotë të gjërmadhëve të krijuara pas mihjes së linjtit;
- 2) Kompensimin e infrastrukturës së rrezikuar dhe/ose të asgjësuar me ndërtim të termocentralit, si dhe atë që duhet ndërtuar sërish (rrugët, ujësjellësin etj.);
- 3) Shërimin e të sëmurëve nga ndotja e emetuar prej termocentralit, si dhe për organizimin e mekanizmave preventivë ndaj efekteve negative shëndetësore që vijnë nga ndotja e emetuar nga termocentralet;
- 4) Rehabilitimin e sipërfaqeve të ndotura bujqësore dhe kompensimin e dëmit që i është shkaktuar bujqësisë;
- 5) Kompensimin e dëmeve të cilat do t'i shkaktohen vendbanimeve të rrezikuara, duke krijuar kushte normale për zhvendosjen e fshatrave të rrezikuara;
- 6) Hartimin e programeve për punësimin e qytetarëve të cilët kanë humbur potencialin për punësim për shkak të shpërnguljes ose tokës së humbur bujqësore;
- 7) Monitorimin e ndotjes së krijuar, me aplikimin e programeve për alarmim në rastet e paraqitjes së ndotjes enorme.

Këto do të ishin vetëm disa nga shpenzimet më evidente nga një shumësi aktiviteteve që duhet të ndërmirëohen për të kompensuar dëmin që shkaktohet nga operimi i termocentraleve Kosova A, Kosova B dhe Kosova C.

iii) Çështje tjetër me rëndësi është bllokimi i potencialit të zhvillimit energjetik të Kosovës brenda 40 viteve të ardhshme. Me ndërtimin e termocentralit Kosova C, Kosova do t'i tejkalojë shumë parametra mjedisorë, të cilët janë të sanksionuar me rregullativat përkatëse ndërkombëtare. Edhe ata parametra që eventalisht nuk do të tejkalohej do t'i afrohen vlerave kufitare të lejueshme, kështu që në të ardhmen do të jetë gati e pamundur të zhvillohet çfarëdo strategjie vetjake energjetike e bazuar në djegie të linjtit. Si rezultat, do të bllokohet tërësisht potenciali ynë zhvillimor deri në periudhën kur do të përfundojë punën termocentrali Kosova C, pra pas 40 vitesh. Kjo çështje do të bëhet edhe më drastike kur dihet se organizmat ndërkombëtarë janë duke e ashpërsuar shumë rregullativën ligjore për mbrojtje të ajrit në rend të parë, për shkak të provave tashmë evidente të paraqitjes së ngrohjes globale.

iv) Zyrtarët e lartë vazhdimisht propagandojnë se projekti 'Kosova C' do ta shpëtojë ekonominë Kosovare dhe, përveç që do ta luftojë terrin aktual, ky projekt do ta bëjë Kosovën fuqi eksportuese në rajon.

1) Terri i kohëpaskohshëm që po e përjetojmë vjen në radhë të parë si rezultat i menaxhimit të dobët të sistemit elektroenergjetik të Kosovës gjatë viteve të kaluara. Humbjet teknike dhe komerciale janë rreth 50%, që do të thotë se në rrethana të menaxhimit më të mirë të këtij sistemi Kosova do të shpenzonte më pak se tani dhe do të kishte në dispozicion së paku edhe 200-300 MW! Me eliminimin e këtyre humbjeve situata energjetike në vend do të përmirësohej dukshëm, e me gjasë edhe do të largohej plotësisht terri aktual.

2) Parulla se Kosova do bëhet fuqi eksportuese po ashtu nuk qëndron. Të paktën nuk qëndron fakti se Kosova do të përfitojë financiarisht nga eksporti i rrymës që do të gjenerohet në termocentralin Kosova C. Pothuajse i tërë profiti i krijuar me eksport të rrymës do të shkojë në llogari të kompanisë së jashtme që do të investojë dhe do ta operojë këtë termocentral. Për më tepër, Kosova do të detyrohet të blejë rrymë nga ky operator si edhe çdo blerës tjetër nga vendet tjera të Ballkanit ose gjetiu, me shpresë të vogël se do mund të arrihet ndonjë aranzhim paksa favorizues. Ajo që Kosova do të "eksportojë" është linjiti. Ai është i vetmi produkt që do t'i shitet operatorit të licencuar, me një çmim ende të diskutueshëm, dhe gjithsesi shumë të pafavorshëm nëse do të realizohen projektet e tanishme lidhur me këtë çështje. Zyrtarisht, në materialin propagandues i cili është duke u prezantuar para opinionit thuhet se linjiti do të shitet me një çmim prej 3

Euro për një ton linjit. Ne anën tjetër, Komisioni i Pavarur i Mineraleve dhe Minierave tashmë ka propozuar çmimin e shitjes së linjitit, në formë të tantumës, propozim ky që është shumë më i vogël se i projektuar nga MEM-i – vetëm 74 cent/t të linjitit, që do të thotë se do të ketë katër herë më pak të hyra në buxhetin e Kosovës sesa që është projektuar.

Sidoqoftë, slogani i preferuar se projekti 'Kosova C' është projekt kombëtar i një rëndësie shumë të madhe është larg realitetit. Ky projekt ka shumë më shumë attribute ndërkombëtare sesa kombëtare: i) do të operohet nga kompanitë ndërkombëtare, ii) profiti i realizuar në pjesën më të madhe do të shkojë jashtë Kosovës, dhe iii) Kosova do të ketë telashe ndërkombëtare për t'iu përmbajtur normave ndërkombëtare mjedisore gjithnjë e më rigorozë.

Çështja e dhjetë: **A duhet sakrifikuar bujqësinë?**

Energjetika në Kosovë duhet zhvilluar dhe do të zhvillohet patjetër edhe në të ardhmen. Mirëpo, përderisa nuk të behën studimet e mirëfillta mjedisore dhe socio-ekonomike, dhe përderisa nuk të harmonizohen konceptet zhvillimore ndërsektoriale, nuk mund të dihet as përafërti se si duhet ta zhvillojmë energjetikën të bazuar në djegie të linjtit në të ardhmen. Prandaj, ka shumë arsye të përfundohet se projekti për ndërtimin e termocentralit Kosova C është tejte i nxituar, meqë nuk bazohet në asnjërën nga parakushtet e lartpërmendura. Kështu, si qëndrojnë punët tani, ndërtimi i termocentraleve vetëm sa gëlltit tokë dhe shkon ndesh me zhvillimin e qëndrueshëm.

KONFLIKTE ZHVILLIMORE

Çështja e dhjetë: A duhet sakrifikuar bujqësinë?

Energjetika në Kosovë duhet zhvilluar dhe do të zhvillohet patjetër edhe në të ardhmen. Mirëpo, përderisa nuk të behën studimet e mirëfillta mjedisore dhe socio-ekonomike, dhe përderisa nuk të harmonizohen konceptet zhvillimore ndërsektoriale, nuk mund të dihet as përafërti se si duhet ta zhvillojmë energjetikën të bazuar në djegie të linjtit në të ardhmen. Prandaj, ka shumë arsye të përfundohet se projekti për ndërtimin e termocentralit Kosova C është tejte i nxitur, meqë nuk bazohet në asnjërën nga parakushtet e lartpërmen-dura. Kështu, si qëndrojnë punët tani, ndërtimi i termocentraleve vetëm sa gëlltit tokë dhe shkon ndesh me zhvillimin e qëndrueshëm.

Ekonomika e eksploatimit të nëntokës ku është i deponuar linjiti tashmë duhet vënë në pyetje për shkak të rritjes intensive të qyteteve dhe fshatrave që gjenden në hapësirën mbi këtë nëntokë. Janë tri elemente të rëndësishme që duhen marrë parasysh gjatë planifikimit të zhvillimit të këtij rajoni: i) zona e gjerë nën të cilën janë të vendosura rezervat e linjtit,⁴³ ii) rrjeti i dendur i vendbanimeve që gjenden mbi këtë zonë⁴⁴ dhe iii) sipërfaqet e tokës pjellore të bonitetit të lartë.⁴⁵ Pa mëdyshje, secili nga këto elemente do duhet zhvilluar në të ardhmen, por po ashtu, pa tjetër, duhet të ndërtohet një koncept i cili do të mundësojë një zhvillim të harmonizuar, pa krijuar konflikte zhvillimore që mund të lindin duke anuar më shumë në njërin pikëpamje ose duke lejuar që zhvillimi i paplanifikuar të cenojë mundësinë e sektorit tjetër për t'u zhvilluar normalisht. Me fjalë tjera, dihet mirëfilli se energjetika e bazuar në linjit dhe bujqësia kanë interesa zhvillimore që janë qenësish konfliktuozë, meqë mbitiba dhe nëntoka nuk mund të shfrytëzohen njëkohësisht. Me zhvillim të energjetikës zihen sipërfaqe të mëdha toke, në rastin e Kosovës të tokës së një bonitetit të lartë bujqësor. Po ashtu, energjetika kërkon shumë ujëra, gjë që në rastet kur resurset ujore janë të kufizuara ose nuk janë të mjaftueshme, siç është rasti në Kosovë, e kufizon dukshëm zhvillimin e bujqësisë dhe sektorëve tjerë. Në anën tjetër zhvillimi stihik dhe i paplanifikuar i vendbanimeve e rrezikon si bujqësinë po ashtu dhe energjetikën.

Me hapjen e minierës së re sipërfaqësore në Fushën e Sibovcit dhe me ndërtimin e termocentralit Kosova C, një sipërfaqe e madhe do t'i merret bujqësisë, por edhe do të zvogëlohet dukshëm hapësira ku do të mund të zhvilloheshin vendbanimet ekzistuese. Kosova ka shumë pak hapësirë të lirë dhe është akoma e vobektë për të organizuar shpërngulje masive të banorëve nga vendbanimet e tyre aktuale në zona tjera të lira dhe të pa rrezikuara. Duhet theksuar se zhvendosja e vendbanimeve nuk mund të bëhet në hapësirat e revitalizuara, ku më parë kanë qenë deponitë e hirit apo të djerrinave, pa kaluar një kohë e konsiderueshme. Sipas disa të dhënave, nevojitet të kalojnë afër 50 vjet për t'u stabilizuar toka e krijuar nga djerrina dhe hiri të rikthyer në gjërmadha të formuara nga mihja e linjtit për të ndërtuar shtëpi mbi te dhe afër 20 vjet për të ndërtuar infrastrukturë rrugore mbi këto sipërfaqe.⁴⁶

Zhvillimi dhe ndërtimi i vendbanimeve mbi basenin e linjtit është një problem serioz dhe delikat i cili duhet zgjidhur me një plan të mirëfilltë hapësinor, të hartuar për tërë zonën e ndikimit të minierave dhe objekteve

43 Vetëm në Rrafshin e Kosovës kjo zonë përfshinë 290km², kurse në tërë Kosovën rreth 440km². Burimi: Enti për Urbanizëm dhe Projektim, Prishtinë.

44 Vetëm mbi sipërfaqen që mbulon rezervat e linjtit gjenden rreth 70 vendbanime, ndërsa në zonën e gjerë të ndikimit, që në vetë përfshin hapësirën me rezerva të linjtit dhe sipërfaqen përreth e cila përcillet me infrastrukturë dhe me ndikueshmëri të ndotjes, zhurmës dhe implikimeve tjera, gjenden rreth 138 vendbanime me mbi 500.000 banorë.

45 Ivovic, P., Kabashi, B., Plani hapësinor regjional i KSA të Kosovës, Faza A, Enti për Urbanizëm dhe Projektim, Prishtinë, 1971.

46 Plani hapësinorë i rajonit të eksploatimit të basenit të linjtit – Baza analitike e planit hapësinorë, IAUS, Beograd 1999.

termoenergjetike, me specifkimi të qartë të hapësirës, sasisë dhe kohës së eksploatimit të linjtit. Përveç kritereve tekno-ekonomike, është e domosdoshme të elaborohen edhe kriteret e çështjet tjera me interes, si: i) pasojat e çrregullimeve në rrjetin e vendbanimeve brenda dhe rreth zonës së eksploatimit, ii) çrregullimet në furnizim dhe qarkullim të ujërave, iii) ndikimi në zona me vlerë mjedisore, iv) funksionimi i infrastrukturës dhe sistemeve tjera të mëdha prodhuese.

Basenet e linjtit në Kosovë janë të vendosur nën tokat bujqësore të bonitetit të lartë. Zakonisht, toka e cilësisë së lartë ruhet me ligje përkatëse. Në rast se toka bujqësore e bonitetit të lartë duhet të shfrytëzohet për qëllime jobujqësore, atëherë shfrytëzuesi është i detyruar të paguajë shumëfishin e çmimit aktual të klasës përkatëse të tokës. Qëllimi i kësaj mase ligjore është ruajtja e resursit jetik - tokës bujqësore; ashtu që mjetet financiare të kompensimit të investohen në shndërrimin e sipërfaqe të reja në tokë bujqësore, duke zbatuar masat përkatëse melioruese.

Korniza 8. Përfitimet nga toka nuk duhen nënçmuar

Ndonëse toka bujqësore nuk paraqet ndonjë resurs i cili siguron shkallë të lartë të rritjes ekonomike, vlera e krijuar nga përpunimi bashkëkohor i saj nuk është për t'u nënçmuar.

Llogaritjet e përfitimeve të mundshme nga përpunimi dhe shfrytëzimi bashkëkohor i tokës së ujitur për prodhimtari bujqësore dhe blegtorale tregojnë se për 1 hektarë ato njehsojnë:

- Nga prodhimtaria bujqësore 3.381 €/ha
- Nga prodhimtaria blegtorale 4.725 €/ha
- Gjithsej 8.106 €/ha

Të njehsuara për sipërfaqen prej rreth 3.200ha, sa llogaritet se do të jetë sipërfaqja vetëm e qitur jashtë përdorimit bujqësor me hapjen e minierës së re në Fushën e Sibovcit, palosjen e djerrinës dhe ndërtimin e termocentralit të ri, përfitimet do të ishin rreth 26 milionë Euro. Nga ana tjetër, sipas planeve për këtë mihje sipërfaqësore në vit do të mihen rreth 16 milion tonë të linjtit, çka sipas çmimit të shitjes prej 0,75€ për 1t linjit, çmim ky që aktualisht qarkullon si i mundshëm, nga mihja e linjtit do të përftoheshin rreth 12 milion Euro në viti, ose për gjysmë më pak sesa që do të përftohej nga shfrytëzimi bujqësor i tokës!

Sipërfaqet tokësore ku janë shtrirë objektet e termocentraleve Kosova A dhe Kosova B janë shumë të mëdha dhe të menaxhuara tejet keq, të pakontrolluara dhe të degraduara gati në tërësi. Edhe sipërfaqet përreth janë të degraduara, qoftë nga ndotësit e liruar nga tymtarët qoftë nga deponitë dhe transporti i hirit. Aktualisht, mihjet sipërfaqësore në Mirash, Dardhishtë dhe së shpejti në Fushën e Sibovcit përfshijnë rreth 6.000ha.⁴⁷ Zëniet indirekte janë shumë më të mëdha. Toka nuk dëmtohet vetëm me mihjen e shtresës së tokës punuese dhe pjellore, si dhe me deponitë e krijuara të hirit dhe djerrinat, por ajo dëmtohet dhe del nga përdorimi i plotë apo i pjesshëm nga shtresimet e hirit të dalë nga tymtarët e termocentraleve.⁴⁸ Ujërat industriale të lëshuara pa trajtim adekuat paraprak shkaktojnë ndotjen e tokës po ashtu. Vite me radhë, një pjesë e ndotësve të rrezikshëm, siç janë fenolët janë lëshuar pa kontroll. Ato kanë duke vërshuar sipërfaqe të konsiderueshme të tokës, me ç'rast janë ndotur edhe lumenjtë dhe ujërat nëntokësorë, duke i bërë ato shumë toksike dhe të rrezikshme.

47 Shiko Çështjen e tetë të kësaj analize.

48 Plani hapësinor i rajonit të eksploatimit të basenit të linjtit – Baza analitike e planit hapësinor, IAUS, Beograd 1999.

Korniza 9. Sa është i dëmshëm fenoli?

Fenoli është komponim shumë i rrezikshëm për shëndetin e njeriut. Në raste akute shkakton iritim në lëkurën dhe mukozën e njeriut. Në rastet e ekspozimit më të gjatë shkakton vdekjen, si pasojë e insuficiencës respiratore, kardiale dhe cirkulatore. Fenoli është shumë toksik dhe për organizmat e gjallë në rrjedhat ujore..

Në kuadër të KEK-ut, fenolët janë krijuar në repartet e Gazifikimit dhe Tertores së linjtit, që kanë funksionuar për disa dekada. Gjatë viteve 1970-1988 në shumë raste ka ndodhur depërtimi i fenolëve deri në rrjedhat ujore të lumit Sitnicë, duke helmuar jo vetëm rrjedhën e këtij lumi por edhe ujërat nëntokësore, bunarët dhe burimet tjera ujore përreth. Gazifikimi i linjtit është mbyllur në vitin 1988, ndërsa Tertorja punon me kapacitet dukshëm të zvogëluar.

Mbetjet e fenolëve nga kohërat e kaluara janë akoma të pranishme në disa nga objektet ekzistuese industriale dhe mjedisin përreth, si dhe në depozitë e ujërave industriale – rreth 850m³ të fenolëve të koncentruar dhe 13.000m³ të ujërave fenolike, që paraqesin rrezik potencial për përsëritje të skenarëve të mëhershëm të abuzimeve mjedisore. Sasi të konsiderueshme të fenolëve janë deponuar edhe në deponinë e hirit të termocentralit Kosova A dhe në minierat e dikurshme nëntokësore në Hade dhe Dardhishtë.

Çështja e njëmbëdhjetë: A kanë ujë ato burime?

Të gjitha studimet e gjertanishme tregojnë se faktori më limitues zhvillimor i Kosovës do të jetë mungesa e ujërave. Në këtë kuptim, posaçërisht do të jetë i goditur rajoni ku ndodhet baseni aktualisht i shfrytëzuar i linjitit dhe ku janë të vendosura pothuajse të gjitha objektet e mëdha industriale të Kosovës, siç janë ato të kompleksit të KEK-ut, Trepçës, Feronikelit, si dhe shumë objekte tjera më të vogla industriale, prodhuese dhe përpunuese. Termocentralet dhe mihjet e linjit janë jo vetëm shfrytëzues të mëdhenj të ujërave por edhe shkaktarë të ndryshimit të regjimit të rrjedhave ujore, si dhe ndotës të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Çështja e njëmbëdhjetë: A kanë ujë ato burime?

Të gjitha studimet e gjertanishme tregojnë se faktori më limitues zhvillimor i Kosovës do të jetë mungesa e ujërave. Në këtë kuptim, posaçërisht do të jetë i goditur rajoni ku ndodhet baseni aktualisht i shfrytëzuar i linjtit dhe ku janë të vendosura pothuajse të gjitha objektet e mëdha industriale të Kosovës, siç janë ato të kompleksit të KEK-ut, Trepçës, Ferronikelit, si dhe shumë objekte tjera më të vogla industriale, prodhuese dhe përpunuese. Termocentralet dhe mihjet e linjit janë jo vetëm shfrytëzues të mëdhenj të ujërave por edhe shkaktarë të ndryshimit të regjimit të rrjedhave ujore, si dhe ndotës të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Është e logjikshme dhe e paevitueshme që gjatë bilancimit të resurseve ujore të një vendi dhe hartimit të planeve për shpenzimin e tyre prioritet i padiskutueshëm t'i jepet plotësimi të nevojave të ndryshme të popullatës dhe bujqësisë – resursit të domosdoshëm për mbijetesë. Kjo do të thotë se energjetika, industria dhe shpenzuesit e tjerë të mëdhenj duhet të zhvillohen në harmoni me sasi të mbetura të resurseve ujore. A do të ndodhë kështu pasi të realizohet projekti për ndërtimin e termocentralit Kosova C? Vështirë mund të besohet se në situatën e mungesës së ujërave për t'i kënaqur nevojat e të gjithëve, termocentrali Kosova C, ose edhe termocentralet tjera eventuale, do të pajtohen me sasi të mbetura të ujërave, pas shfrytëzimit të tyre nga popullata dhe bujqësia. E resurset ekzistuese ujore nuk do mund t'i kënaqin nevojat e të gjithëve!

Kosova që tani ka probleme të theksuara me furnizim me ujë, sidomos me ujë të pijshëm. Me trendin e tanishëm të shtimit natyror të popullatës dhe parashikimeve të shtimit në të ardhmen këto probleme vetëm sa do të shtohen.

Hapësira ku gjendet baseni i linjtit i rrafshit të Kosovës është posaçërisht e rrezikuar në pikëpamje të furnizimit me ujë dhe pas një kohe relativisht të shkurtër do të shteren pothuajse të gjitha mundësitë për furnizim me ujë të të gjithë shfrytëzuesve. Kufizimet që e karakterizojnë këtë situatë janë ilustruar në korrikun 10.

Janë tri problemet vijuese, ato që posaçërisht e rëndojnë situatën e furnizimit afatgjatë me ujë:

- Gjendja jo e favorshme e potencialeve ekzistuese ujore në rajonin e basenit të linjtit të rrafshit të Kosovës tashmë e kufizon dukshëm zhvillimin e kapaciteteve të reja energjetike dhe industriale; pas fillimit të punës të termocentraleve të reja dhe objekteve industriale që akoma nuk kanë filluar punën (Trepça, Ferronikeli etj.) në dispozicion do të mbesin sasi shumë të vogla të ujit, që shpesh nuk do të mund të garantojnë as mbajtjen e minimumit biologjik dhe ekologjik; ky do të jetë kufizimi më i ashpër që do t'i imponohet projekteve zhvillimore të termocentraleve.
- Zvogëlimi i potencialeve për qasje në sasi të bollshme të ujit krijon konflikte të rrezikshme të intereseve të shfrytëzuesve të ujit, çka në formën më të ashpër do të vjen në shprehje në rajonin e minierave dhe termocentraleve aktuale. Konflikti do të jetë posaçërisht i vështirë kur duhet ndarë ujin për nevojat e energjetikës dhe industrisë në njërin anë dhe për nevojat e ujitjes së tokave bujqësore në anën tjetër; në situatën kur deficit i ujërave do të jetë më i theksuari, zgjidhja e konfliktit ndërmjet energjetikës dhe industrisë dhe bujqësisë do të paraqet sfidë tejet serioze shoqërore.

Korniza 10. Potencialet ujore dhe nevojat për ujë për rajonin përreth basenit të Kosovës

-Çështja e bilancit të resurseve ujore nuk është shtruar asnjëherë pas luftës nga ana e institucioneve përgjegjëse për këtë çështje me rëndësi vitale.

Sipas llogaritjeve të verifikueshme, bilanci i nevojave vjetore është si vijon:

- Nevojat e popullatës së rajonit që në të ardhmen duhet të furnizohen me ujë të pijshëm nga hidrosistemi “Ibër-Lepenc”104,0 milionë m³
- Nevojat për ujitje të 20.000ha të tokave bujqësore të parapara të furnizohen nga hidrosistemi “Ibër-Lepenc”65,0 milionë m³
- Nevojat për ujë të komplekseve të mëdha ekzistuese industriale (Trepça, Ferronikeli dhe termocentralet Kosova A dhe Kosova B130,0 milionë m³
- **Gjithsej**299,0 milionë m³

Potenciali vjetor ujqor i lumit Ibër, që realizohet nëpërmjet liqenit të Ujmanit, njehson rreth 410,0 milionë m³. Nga ana tjetër, shpenzimet dhe humbjet vjetore të ujit nga ky liqen do të jenë:

- Minimumi biologjik 16,0 milionë m³
- Uji i ‘vdekur’19,0 milionë m³
- Vëllimi i liqenit i zënë me aluvion21,0 milionë m³
- Avullimi i ujit nga sipërfaqja e liqenit14,0 milionë m³
- **Gjithsej**70,0 milionë m³

Nga këto të dhëna del se në vitin 2050 nga liqeni i Ujmanit në dispozicion do të jenë gjithsej 340,0 milionë m³ ujë!

Marrë parasysh këto të dhëna, në të ardhmen do të disponohet mesatarisht vetëm me 1,3m³/s për të gjitha nevojat që do të paraqitën në fazat e ardhshme zhvillimore të Kosovës, pa përfshirë këtu sasitë e ujit që do të nevojiten për termocentralin e ri Kosova C. Duhet theksuar se në periudhat kur rrjedhat e ujit në Kosovë janë të zvogëluara në krahasim me ato mesatare, rrjedha e ujit në dispozicion do të jetë shumë më e vogël.

- Mihjet sipërfaqësore ushtrojnë ndikim shumë negativ në cilësinë e ujërave nëntokësore. Për shkak të keqësimit të cilësisë së këtyre ujërave, një numër i madh i shpenzuesve që furnizohen nga burimet nëntokësore do duhet të orientohet kah ujësjellësit rajonalë, çka do të ketë për pasojë rritjen e presionit për shfrytëzim të ujërave sipërfaqësore, të cilat edhe ashtu janë të pakta.

Siç është theksuar edhe më parë, resurset ujore në Kosovë përveç që janë të pakta, janë edhe të shpërndara në mënyrë jo të njëtrajtshme, përkatësisht në disa rajone ato janë më të bollshme kurse në disa tjera më të pakta. Rrjedhat specifike të lumenjve në zonën qendrore të Kosovës janë shumë të ulëta, rreth 2-4 l/s km², dhe bën pjesë në zonat më të varfra me ujë në Ballkan. Rrjedhat e mëdha të ujërave, rreth 30 l/s km² gjenden buzë maleve të Sharrit dhe të Bjeshkëve të Nemuna. Në viset e banuara dendur, siç është situata në rajonin

përreth termocentraleve ekzistuese, resurset ujore në dispozicion për kokë banori janë shumë të vogla, nën 500m^3 për banor në vit. Kjo sasi është pesë herë më e vogël sesa që është kufiri i normave për nivelin e furnizueshmërisë vetjake me ujëra, pa rrezikim të ekosistemeve ujore.

Pasi që aktualisht nuk është e mundur që nevoja për ujëra në rajonet e varfra të kompensohet me prurje të ujit nga rajonet e tjera brenda Kosovës ose nga vendet fqinje me Kosovën, ekziston vetëm një zgjidhje racionale - zvogëlim radikal i shpenzimit të ujit. Natyrisht, ky zvogëlim nuk mund të bëhet duke e privuar popullatën nga uji. Po ashtu, nuk do të duhej të zvogëlohej as sasia e ujit që përdoret për ujitje, sidomos të tokave të bonitetit të lartë. I vetmi zvogëlim i shpenzimit që do të mund të bëhej është zvogëlimi për nevoja të energjetikës dhe industrisë. Por, duke marrë parasysh planet e tanishme për ndërtimin e termocentralit Kosova C, hapjen e minierave dhe aktivizimin e Trepçës dhe Ferronikelit, mund të thuhet se këto plane janë një “mision i pamundur”, përveç nëse nuk mëtohet lënia e bujqësisë pa ujëra e ndoshta edhe t’i zvogëlohet popullatës sasia e ujit e nevojshme për përmbushje të nevojave të saj!

Në dekadat e ardhshme, kur do të shtohet presioni demografik në këtë zonë dhe kur pritet një rritje e konsiderueshme të popullatës në të, nga korniza 10 është evidente se uji do të jetë faktor i madh kufizues i zhvillimit normal të jetës si dhe përparimit të shumë degëve të ekonomisë. Në këtë situatë, çdo ndërtim i termocentraleve të reja do duhej t’i merrte parasysh kufizimet e lartpërmendura. Termocentralet që përdorin teknologjitë më moderne sot shpenzojnë rreth $0.6\text{--}0.8\text{ m}^3/\text{s}$ për 1.000MW fuqi, që është sasi shumë e madhe për t’u ndarë po që se merret parasysh fakti se në periudhat kritike të vitit sasia e tërësishme në dispozicion është edhe më e vogël sesa që do të duhej të shpenzonin termocentralet.

Çështja e dymbëdhjetë:

A duhet rrezikuar edhe më tej shëndetin e popullatës?

Është çështje evidente se ndotja e ajrit që vjen nga termocentralet shkakton probleme serioze shëndetësore. Astma, sëmundjet respiratore, sulmet në zemër dhe vdekjet e parakohshme janë më të shpeshtat. Studimet e bëra në vende të ndryshme tregojnë se me dhjetëra mijëra njerëz vdesin para kohës dhe se me qindra mijëra vuajnë nga sulmet e astmës si rezultat i ndotjes së ajrit nga termocentralet. Edhe studimet e bëra nga autorët kosovarë tregojnë se ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet emisionit të gazrave të ndryshme dhe pluhurit nga termocentralet Kosova A dhe Kosova B dhe shpeshtësisë së paraqitjes së sëmundjeve respiratore te punëtorët e termocentraleve dhe minierave, si dhe te popullata që jeton në zonën e ndikimit të këtyre impianteve energjetike.

Çështja e dymbëdhjetë: A duhet rrezikuar edhe më tej shëndetin e popullatës?

Është çështje evidente se ndotja e ajrit që vjen nga termocentralet shkakton probleme serioze shëndetësore. Astma, sëmundjet respiratore, sulmet në zemër dhe vdekjet e parakohshme janë më të shpeshtat. Studimet e bëra në vende të ndryshme tregojnë se me dhjetëra mijëra njerëz vdesin para kohës dhe se me qindra mijëra vuajnë nga sulmet e astmës si rezultat i ndotjes së ajrit nga termocentralet.⁴⁹ Edhe studimet e bëra nga autorët kosovarë tregojnë se ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet emisionit të gazrave të ndryshme dhe pluhurit nga termocentralet Kosova A dhe Kosova B dhe shpeshtësisë së paraqitjes së sëmundjeve respiratore te punëtorët e termocentraleve dhe minierave, si dhe te popullata që jeton në zonën e ndikimit të këtyre impianteve energetike.

Studime të shumta janë bërë përkitazi me lidhshmërinë që ekziston ndërmjet ndotjes së emetuar nga termocentralet dhe sëmundjeve të ndryshme të cilat i shkaktohen popullatës e cila jeton brenda hapësirës së ndikimit të termocentraleve. Në kornizën 11 janë paraqitur rezultatet e studimeve më të reja të bëra në ShBA lidhur me këtë problematikë. Nga kjo kornizë shihet se ekziston korrelacion i drejtpërdrejtë ndërmjet ndotjes të emetuar nga termocentralet dhe sulmeve në zemër, kancerit në mushkëri, vdekjes së parakohshme, sëmundjeve respiratore, si dhe pasojave tjera shëndetësore të cilat i kushtojnë shoqërisë në tërësi. Marrë parasysh dallimin ndërmjet shkallës së zhvillimit të Kosovës dhe ShBA-ve, është e qartë se efektet negative të ndotjes nga termocentralet në popullatën kosovare janë më të mëdha se ato që janë paraqitur në kornizën 11.

Edhe autorët kosovarë janë marrë me studimin e kësaj dukurie në mjediset e ndotura nga termocentralet ekzistuese. Në punimet e shumta profesionale dhe shkencore të tyre jepen dëshmi të pamohueshme mbi lidhshmërinë ndërmjet ndotjes nga termocentralet Kosova A dhe Kosova B dhe sëmundjeve të punëtorëve dhe qytetarëve që jetojnë në zonën e ndikimit të këtyre termocentraleve. Më së shumti janë hulumtuar sëmundjet e frymëmarrjes dhe është signifikante paraqitja e këtyre sëmundjeve në rajonin e Kastriotit, Ferizajt dhe Hanit të Elezit. Sëmundjet obstruktive kronike të mushkërive, si problem social mjekësor, viteve të fundit kanë tërhequr vëmendje të madhe për shkak të paraqitjes më të madhe të tyre te punëtorët e KEK-ut, posaçërisht te grupimet e caktuara, para së gjithash të atyre që punojnë në hapësirat me ajër të ndotur me gazra dhe pluhur. Në rastet më të shpeshta përbërësit që risin shpeshtësinë e sëmundjeve respiratore, sidomos atyre akute, e që nuk gjinden gjatë kontrollimeve preventive, janë dyoksidi i sulfurit dhe oksidet e azotit.

Studimet e autorëve kosovarë brenda periudhës 1982-2006 kanë vënë në pah qartazi se pjesëmarrja e sëmundjeve respiratore në sëmundshmërinë e përgjithshme të punëtorëve të punësuar në kuadër të KEK-ut ka njëhsuar rreth 30%. Krahasuar me viset ku nuk ka objekte të termocentraleve, ku kjo pjesëmarrje ka njëhsuar 9,21%, sëmundjet respiratore te punëtorët e KEK-ut janë rreth tri herë (300%) më të pranishme sesa të mesatarja për popullatën në viset tjera të Kosovës.⁵⁰

49 Bascom, R. et al., *Health Effects of Outdoor Air Pollution, Part 1*, 153 American Journal of Respiratory and Critical Care Medicine 3-50 (1996); Bascom, R. et al. *Health Effects of Outdoor Air Pollution, Part 2*, 153 American Journal of Respiratory and Critical Care Medicine 477-498 (1996).

50 Xh. Pllana e tj., *Mbrojtja e ambientit dhe shëndetit në Kosovë, me theks të veçantë në Kastriot*, Seminar për Mbrojtjen e Ambientit, Prishtinë, 2002.

Korniza 11. Efektet e ndotjes nga termocentralet në shëndetin e popullatës

(studim i bërë në SHBA)¹⁰

- Grimcat e imëta ndotëse nga impiantet e energjisë në SHBA u shkurtojnë jetën e rreth 24.000 njerëzve çdo vit, përfshirë 2.800 të vdekur nga kanceri i mushkërive.
- Mesatarja e viteve të humbura të jetës nga individë që kanë vdekur para kohe nga ekspozimi ndaj materieve grimcore është 14 vjet.
- Qindra mijëra amerikanë vuajnë çdo vit nga sulmet e astmës, problemet e zemrës dhe problemet e rrugëve të frymëmarrjes që ndërlidhen me grimcat e imëta nga impiantet e energjisë. Këto sëmundje rezultojnë më dhjetëra mijëra raste emergjente, hospitalizime dhe humbje të ditëve të punës për çdo vit.
- Ndotja e shkaktuar nga impianti i energjisë është përgjegjëse për 38.200 sulme jo fatale të zemrës për çdo vit.
- Të moshuarit, fëmijët dhe ata me sëmundje rerespiratore preken më së shumti nga grimcat e imëta që shkaktohen nga impianti i energjisë.
- Njerëzit që jetojnë në hapësirat metropolitane afër termocentraleve nga qymyri e ndiejnë ndikimin e tyre në mënyrë më akute – shkalla e vdekjes te ata është shumë më e lartë se sa në hapësirat me më pak impiante të qymyrit të ndezur

Sipas mendimit të disa ekspertëve mjekësorë vendës,⁵¹ veprimi afatgjatë i materieve të dëmshme me përqendrim të vogël në ajër paraqet rrezik më të madh për shëndetin e njerëzve, për arsye se përqendrimet e vogla zakonisht tolerohen për shkak të mosparaqitjes dramatike të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë të cilën e shkaktojnë, ndërsa veprimet afatshkurta të këtyre ndotësve kur paraqiten me përqendrime të larta vërehen menjëherë dhe si reagim kanë paraqitjen e menjëhershme të të sëmurëve të mjeku dhe caktimin e masave mbrojtëse.

Gjatë planifikimit të kapaciteteve të reja termoenergjetike në Kosovë, sfidë e veçantë shoqërore do të jetë parashikimi me kohë i ndikimeve të objekteve që do të ndërtohen në shëndetin e popullatës dhe veprimi preventiv i cili do të sigurojë ndërtimin e kapaciteteve që nuk do të përkeqësonin gjendjen shëndetësore të saj. Krahës kësaj, me rëndësi është edhe llogaritja e përpiktë e kostos së veprimit negativ të ndotjes në shëndet, në mënyrë që edhe ajo të kuptohet si pasojë e ndotjes që duhet kompensuar, për të mundësuar eliminimin ose shërimin e sëmundjeve që do të lajmërohen. Kjo kosto nuk është e vogël, dhe shumë rrallë qeveritë merren me këtë çështje. Është normale të pritët që nëse ndonjë investitor do të përfitojë nga biznesi i cilin do ta zhvillojë, atëherë ai do duhej të jetë i gatshëm edhe të paguajë për të mënjanuar pasojat negative që i shkakton biznesi i tij. Shumë organizata ndërkombëtare të specializuara tanimë janë marrë me përcaktimin e çmimit shëndetësor të ndotjes. Nga një studim i bërë nga ExterneE⁵² shihet se çmimi i efekteve eksterne, përkatësisht çmimi që duhet paguar për evitimin/ shërimin e dëmeve të shkaktuara, njehson mesatarisht

51 E. Baraku, Vlersimi i lëvizjes së morbiditetit në Kombinatin „Kosova” në Prishtinë për periudhën 1966-1975, Tezë e doktoratës, Prishtinë, 1976.

52 <http://www.externe.info>

rreth 6.439-11.048\$ për 1t të SO_2 të emetuar, 7.945-12.302\$ për 1t të NO_x të emetuar dhe 11.200-22.462\$ për 1t të grimcave të emetuara të pluhurit.⁵³ Ky vlerësim është bërë për disa shtete të Bashkimit Evropian. Të shndërruara në vlerë për njësi të energjisë së prodhuar, shpenzimet eksterne të termocentralit me qymyr njehsojnë 5,3 – 5,8 cent/kWh të energjisë së prodhuar. Në rastin e ndërtimit të një termocentrali të ri me fuqi 2.100MW dhe me 7.200 orë punë në vit këto shpenzime për shoqërinë kosovare do të njehsonin 763,2 – 835,2 milion dollarë amerikanë në vit!



Figura 5. Aduhet lejuar këtë?

(Schneider, C.G., *Dirty Air, Dirty Power*, Mount Vernon Printing, June 2004)

53 <http://www.externe.info>

Çështja e trembëdhjetë: **Kënd ndihmon komuniteti ndërkombëtarë?**

Komuniteti ndërkombëtarë në Kosovë ka investuar shumë në zhvillimin e energjetikës pas luftës. Deri tani ka shpenzuar rreth 700 milion Euro në projektet e mëkëmbjes së objekteve energjetike të Kosovës. Të numërta kanë qenë organizatat dhe agjencitë ndërkombëtare të cilat kanë investuar dhe punuar jashtëzakonisht shumë për zhdukjen e territ në Kosovë: Banka Botërore, AER-i, USAID-i, SIDA etj. Posaçërisht duhet veçuar kontributin e Bankës Botërore dhe AER-it në të gjitha domenet zhvillimore të energjetikës. MEM-i propanon se këto agjenci e mbështetin pa rezervë edhe projektin 'Kosova C – 2.100MW'. A qëndron vërtet një pohim i tillë, për një projekt aq të paqëndrueshëm ?

Çështja e trembëdhjetë: Kënd ndihmon komuniteti ndërkombëtarë - zhvillimin energjetik të Kosovës apo projektin "Kosova C"?

Komuniteti ndërkombëtarë në Kosovë ka investuar shumë në zhvillimin e energjetikës pas luftës. Deri tani ka shpenzuar rreth 700 milion Euro në projektet e mëkëmbjes së objekteve energjetike të Kosovës. Të numërta kanë qenë organizatat dhe agjencitë ndërkombëtare të cilat kanë investuar dhe punuar jashtëzakonisht shumë për zhdukjen e territ në Kosovë: Banka Botërore, AER-i, USAID-i, SIDA etj. Posaçërisht duhet veçuar kontributin e Bankës Botërore dhe AER-it në të gjitha domenet zhvillimore të energjetikës. MEM-i propanon se këto agjenci e mbështetin pa rezervë edhe projektin 'Kosova C – 2.100MW'. A qëndron vërtet një pohim i tillë, për një projekt aq të paqëndrueshëm ?

Ekziston një shpërputhje e madhe ndërmjet rolit që MEM-i u atribuon projekteve të agjencive ndërkombëtare, duke i vënë ato plotësisht brenda agjendës së vet si përkrahëse të mëdha të projektit Kosova C, dhe qëndrimit që ato realisht e kanë marrë karshi këtij projekti.⁵⁴ E vërteta është se nuk mund të gjendet asnjë dokument ku Banka Botërore ose AER-i, apo edhe ndonjë mbështetës tjetër i madh i energjetikës në Kosovë, do të jenë deklaruar në mënyrë eksplicite se e mbështesin ndërtimin e termocentraleve të reja sipas skenarit të përgatitur nga MEM-i, përkatësisht që termocentrali i ri duhet të jetë me kapacitet 2.100MW dhe se investitorët e jashtëm ftohen për ta ndërtuar atë dhe për të operuar me të brenda 40 viteve të ardhshme, duke përfshirë edhe minierën e re në Fushën e Sibovcit. Banka Botërore, AER-i, USAID-i dhe agjencitë tjera janë involvuar në disa projekte të mëdha të cilat kanë hulumtuar pikëpamje të ndryshme të zhvillimit të energjetikës, duke studiuar segmente të veçanta të cilat padyshim do të ndihmojnë në përcaktimin e politikave energjetike në Kosovë.⁵⁵ Mirëpo, pothuaj se në secilin material propagandues lidhur me projektin 'Kosova C – 2.100MW' thuhet se ky projekt e ka përkrahjen e plotë ndërkombëtare.

A mund të fajësohen Banka Botërore, AER-i dhe të tjerët lidhur me këtë çështje dhe cili është kontributi i tyre në këtë? Nëse këto organizata janë involvuar dhe kanë shpenzuar aq shumë deri tash në riparimin e termocentraleve ekzistuese si dhe në zhvillimin e energjetikës në përgjithësi, atëherë shumë vështirë mund të kuptohet pse ato nuk marrin qëndrim të artikuluar qartë karshi ndërtimit të termocentralit Kosova C, një projekti i madh ky që në mënyrë të pariparueshme do të ndikojë në zhvillimet e ardhshme në Kosovë, jo vetëm në mjedis, por edhe në ekonomi, bujqësi, zhvillime urbane, demografike, sociale etj. Nuk është e qartë për çfarë arsye këto organizata nuk prononcohen zyrtarisht se ato nuk qëndrojnë prapa skenarëve të ndërtimit të termocentralit Kosova C – 2.100MW, ashtu siç po prezantohen nga MEM-i, për një projekt me të cilën pasuria minerare e Kosovës do të jepet me koncesion për 40 vjet. Në të vërtetë, pse këto organizata në vazhden e shumë studimeve të cilat i financojnë nuk i japin prioritet ndonjë studimi i cili paraprakisht do t'i adresonte problemet e ngritura në këtë analizë: mjedisore, sociale, ekonomike etj. Çështje e vërteta, Banka Botërore dhe AER-i gjithmonë kanë theksuar se do t'i ndihmojnë këto studime, por pse nuk janë duke e parë se dinamika e studimit të çështjeve të përmendura aspak nuk është duke e ndjekur dinamikën e zhvillimeve që projektin 'Kosova C – 2.1000' do ta bëjnë 'biznes të kryer'? Pra, ekziston një kundërti e madhe ndërmjet dy proceseve: procesit që e dikton MEM-i për përmbylljen e kontratës me investitorin privat, që sipas saj duhet të përfundojë në vjeshtë të këtij viti, dhe procesit që i prijnë organizatat ndërkombëtare për studim më të mirë të potencialit, sfidave dhe pasojave të zhvillimit energjetik në Kosovë, në bazë të të cilit qeveria

54 Një frymë e tillë e "përvetësimit" të qëndrimeve të organizatave ndërkombëtare që ndihmojnë zhvillimin e Kosovës haset në shumë materiale propaganduese të MEM-it. Kështu, në kumtesën për shtyp të MEM-it të datës 16 mars 2007 thuhet: "Projekti ... ka një përkrahje të fuqishme të USAID-it, Bankës Botërore, AER-it dhe të KFW-së...".

55 Të shumta janë projektet e tilla: ESTAP I, II dhe III, LOT1 dhe LOT2, etj.

kosovare do duhej t'i përcaktonte kahet zhvillimore dhe projektet konkrete për t'i realizuar. Në këtë moment, duke marrë parasysh një shtytje nxituese që i jepet projektit 'Kosova C -2.110MW' nga MEM-i, duket se komuniteti ndërkombëtar do të mbetet shumë pas në këtë garë të padeklaruar.

Korniza 12. Banka Botërore, ODEA Annex B

Kriteret për një raport të plotë të "Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis"

...

(c) Përshkrim i projektit. Përshkrimi konciz i kontekstit gjeografik, ekologjik, social dhe të përkohshëm të projektit, përfshirë ndonjë investim të jashtëm që mund të kërkohej nga projekti (p.sh. tubacionet e dedikuara, rrugët e transportit, termocentralet, furnizimi me ujë, banimi dhe pajisjet për lëndë të parë dhe ruajtje të produktit).

(d) Të dhënat fillestare. Vlerësimi i dimensioneve të zonës së studimit dhe përshkrimi i kushteve relevante fizike, biologjike dhe socioekonomike, përfshirë ndonjë ndryshim të parashikuar para nisjes së projektit. Aktivitetet e tashme dhe të propozuara zhvillimore brenda zonës së projektit (jo drejtpërdrejtë të lidhura me projektin) duhet të merren parasysh.

(e) Ndikimi mjedisor. Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve pozitive dhe negative që mund të rezultojnë nga projekti i propozuar. Duhet identifikuar masat zbutëse, dhe ndonjë ndikim të mbetur negativ që nuk mund të evitohet. Duhet hulumtuar mundësitë për avancim të cilësisë së mjedisit. Niveli dhe cilësia e të dhënave të disponueshme, mungesa e të dhënave, dhe pasiguritë që lidhen me parashikime duhet të identifikohen/parashikohen. Temat që nuk kërkojnë kujdes të mëtejshëm duhet të specifikohen.

(f) Analizimi i alternativave. Krahasimi sistematik i modelit të propozuar investiv, vendit, teknologjisë dhe alternativës operationale në kuptim të ndikimeve potenciale të tyre në mjedis; kostot kapitale dhe periodike; qëndrueshmëria nën kushtet lokale; dhe nevojat institucionale, për trajnim dhe monitorim. Për secilën alternativë, kostot dhe benefitet ambientale duhet të përcaktohen në masën më të gjerë të mundshme, si dhe aty ku është e mundur duhet bashkëngjitur vlerat ekonomike. Duhet të ceket kriteri bazë për përzgjedhjen e alternativës së propozuar për disenj të projektit.

(g) Plani për reduktim të ndotjes. Identifikimi i masave të mundshme dhe me kosto të përshtatshme që mund të zbusin ndikimet potencialisht të dëmshme mjedisore; kostot kapitale dhe periodike; dhe nevojat institucionale, për trajnim dhe monitorim të këtyre masave. Plani (i njohur edhe si "plan veprimi", apo "plani i zbutjes ose menaxhimit ambiental") duhet të ofrojë detaje mbi programet dhe planet aksionare të propozuara të punës. Këto detaje nevojiten për t'u siguruar që veprimet e propozuara mjedisore të jenë të sinkronizuara me zbatimin dhe aktivitetet tjera të projektit gjatë implementimit. Plani duhet t'i ketë parasysh masat kompensuese në rast se masat për zbutje nuk janë të mundshme apo kanë kosto të lartë.

...

Çka është duke e turbulluar optikën reale të kësaj çështjeje? Asgjë nuk mund të thuhet me siguri të plotë. Megjithatë, edhe pse në mungesë të informatave të sakta dhe të besueshme, mirëpo me një dozë rezerve, mund të konstatohet:

i) Njëra ndër mangësitë e projektit 'Kosova C' konsiston në faktin se është duke u zhvilluar në bashkëpunim të drejtpërdrejtë në mes të qeverisë, përkatësisht MEM-it, dhe investitorit privat. Banka Botërore dhe AER-i nuk kanë rol konkret në këtë aranzhman. Kjo me gjasë e bën të pamundur zbatimin e normave të cilat Banka Botërore i vë në veprim në rastet kur ajo bëhet kredithënëse. Me gjasë kjo vlen edhe për AER-in. Po qe se edhe pjesërisht qëndron ky konstatim, atëherë është e logjikshme të shtohet pyetja se pse Banka Botërore nuk sugjeron së paku që të përmbushen kriteret që ajo i zbaton në rastet kur ajo e financon ndërtimin e termocentraleve? Zbatimi i këtyre kriterëve do ta avanconte dukshëm vendimmarrjen demokratike, si dhe përcaktimin e kapaciteteve dhe skenarëve konkretë për ndërtimin e termocentraleve të reja.

ii) I tërë rajoni në të ardhmen do të ketë mungesë të shprehur të energjisë në përgjithësi. Institucionet ndërkombëtare si Banka Botërore dhe AER-i janë shumë të angazhuara në drejtim të sigurimit të një perspektive zhvillimore të sistemit rajonal energjetik si dhe të projekteve nacionale. Një gjë e tillë është e kuptueshme dhe shikuar nga kjo perspektivë projekti 'Kosova C' do të sjell shumë përparësi në avancimin e situatës energjetike në rajon. Nëse Kosova me vullnetin e vet dëshiron të futet në një projekt që do t'i sigurojë tërë rajonit prosperitet, atëherë do të ishte e kuptueshme që organizatat ndërkombëtare ta mbështetnin interesin rajonal ndaj atij lokal? Mirëpo, nuk është e kuptueshme që një gjë e tillë të bëhet përkundër mangësive të cilat e karakterizojnë projektin 'Kosova C', me pasojë të shumta për popullatën lokale.

PËRFUNDIME dhe REKOMANDIME

PËRFUNDIME

1. Termocentrali Kosova C – 2.100MW nuk do duhej ndërtuar përderisa nuk të jenë siguruar informata të bollshme të cilat do të dëshmojnë se:

- a) efektet e këtij termocentrali në ajër, ujë dhe tokë nuk do të jenë negative deri në atë masë që do të:
 - i) rrezikonin shëndetin e popullatës,
 - ii) tejkalonin normat e caktuara me ligjet nacionale dhe normat ndërkombëtare për emisionin e ndotësve dhe
 - iii) rritnin nivelin e ndotësve në ambient;
- b) janë shmangur konfliktet zhvillimore, duke ofruar zgjidhje të qëndrueshme për bashkëveprim të sektorëve të ekonomisë siç janë bujqësia, ekonomia ujore, zhvillimi hapësinor dhe urban;
- c) analizat ekonomike sigurojnë pjesëmarrje sa më të madhe të kapitalit vendor në investime dhe leverdi ekonomike maksimale vendëse.

2. Kapaciteti i propozuar për ndërtim prej 2.100MW dhe skenari ekonomik sipas të cilit investitori i jashtëm do të jetë i vetmi investues do të sjellin efekte të shumta negative në mjedis, hapësirë, zhvillim demografik, etj., dhe janë me leverdi të pamjaftueshme ekonomike për vendin, marrë parasysh përmasat e projektit.

3. Iniciativa për ndërtim dhe hapat e ndërmarra deri tani dëshmojnë se nuk janë duke u respektuar sa duhet normat dhe procedurat që dalin nga ligjet kombëtare dhe nga konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

4. Komuniteti ndërkombëtar, përkundër rolit shumë aktiv dhe mbështetës që kishte për zhvillimin e energjetikës në Kosovë, nuk i është adresuar çështjes së projektit të MEM-it në mënyrë të drejtë, duke lejuar hapësirë që të keqinterpretohet roli i tyre në zhvillimin e sektorit të energjisë në Kosovë.

5. Promovimi i projektit nga MEM-i ndër qytetarë të Kosovës është shumë larg përmbushjes së normave dhe kriterëve të përcaktuara me konventa ndërkombëtare, të cilat duhet të garantojnë transparencë dhe pjesëmarrje aktive të qytetarit në vendimmarrje.

6. Kosova karakterizohet me shumë kufizime natyrore për të eksploatuar linjtin në përmasa të mëdha pa shkaktuar shumë dëme; zhvillimi i ardhshëm energjetik duhet të bazohet edhe në resurse tjera, siç janë uji, dielli, era etj.

7. Menaxhimi efektiv i termocentraleve ekzistuese si dhe investimet për minimizim të humbjeve komerciale dhe teknike janë shumë të rëndësishme për perspektivën zhvillimore të këtij sektori; zgjidhja e tyre do të ndikonte pozitivisht në evitimin e një pjese të madhe të problemeve aktuale të cilat shkaktohen nga termocentralet.

REKOMANDIME

Qeverisë së Kosovës:

- i) Ta prolongojë afatin e shpallur për ndërtimin e termocentralit Kosova C, duke krijuar hapësirë dhe kohë për të studiuar më mirë efektet pozitive dhe negative të këtij projekti, nëse paraprakisht nuk hartohen :
 - a. elaborati paraprak për të gjitha kufizimet dhe konfliktet që e përcjellin zhvillimin energjetik, në rend të parë ato mjedisore, ekonomike dhe sociale;
 - b. Vlerësimi Strategjik i Mjedisit në pajtim me normat e BE-së dhe Bankës Botërore për investime të këtij lloji;
 - c. studimet e ndërhyrjeve sektoriale dhe kufizimet e ndryshme me të cilat projekti 'Kosova C' mund të jetë shkaktar i konfliktit potencial ndërmjet energjetikës, bujqësisë dhe zhvillimeve sociale-urbane;
 - d. plani hapësinor për zonën e ndikimit të termocentraleve të reja;
 - e. plani kryesor i ujërave, me theks të veçantë në gjendjen aktuale dhe potencialin e furnizimit në zonën e paraparë për realizimin e projektit 'Kosova C'.
- ii) Të përgatisë procesin e diskutimeve publike të mirëfillta, duke u bazuar në sugjerimet dhe obligimet që dalin nga Konventa e Aarhusit lidhur me:
 - a. informimin e drejtë të qytetarëve për mundësitë, sfidat, problemet dhe kufizimet mjedisore dhe sociale të ndërtimit të kapaciteteve të reja termoeenergjetike, duke iu komunikuar në mënyrë transparente rezultatet e studimeve të mirëfillta të cilat do të bëheshin në ndërkohë;
 - b. përfshirjen e qytetarit në procesin e vendimmarrjes për një projekt kaq të madh zhvillimor, në pajtim me sugjerimet e kësaj konvente.
- iii) Të përgatiten studimet ekonomike që do të sjellin variante të ndryshme të mundshme për ndërtimin e të kapaciteteve të reja energjetike, duke synuar që leverdia ekonomike e këtij projekti të jetë sa me e madhe, me ç'rast:
 - a. do të studioheshin mirë të gjithë strukturat dhe modelet e mundshme për investime dhe kredimarrje që Kosovën do ta bënin bashkë-investitor në projekt, me çka do të sigurohej një profit më i madh vetjak;
 - b. nga profiti përkatës do të siguroheshin mjete të mjaftueshme për t'i investuar në programet e sanimit të gjendjes së krijuar në mjedis, shëndetësi, prodhimtari të humbur në bujqësi etj.
- iv) Së bashku me KEK-un të hartohet plani për ndërprerjen sa më të shpejtë të punës së termocentralit Kosova A dhe të ofrojë opsione të ndryshme për zëvendësim të shpejtë të fuqisë që do të mungonte pas mbylljes së tij. Ky plan do mund të merrte parasysh **sugjerimet vijuese**:
 - a. ndërtimin e kapaciteteve të reja energjetike, që nuk do duhej të tejkalonin 500MW fuqi, që do të mund të ndërtoheshin shpejt, si një apo dy blloqe të reja që do t'i bashkëngjiteshin termocentralit Kosova B. Lidhur me këtë do duhej bërë një studim i shpejtë i fizibilitetit, pas elaborimit të studimeve të theksuara më lart, dhe do **duhej përcjellë me alternativa investuese**, duke synuar angazhimin sa më të madh të kapitalit kosovar në të;

- b. studimi i fizibilitetit për blloqe të reja të bashkëngjitura termocentralit Kosova B do duhej t'i përmbajë edhe opsionet për investime në teknologjitë për reduktimin e ndotjes që vjen nga blloqet ekzistuese të këtij termocentrali.
- v) Të studiohen mundësitë që në rast se nuk do të ndërtoheshin si blloqe shtesë të termocentralit Kosova B, objektet e reja termoenergjetike të ndërtoheshin medoemos në një lokacion të ri, i cili do të ishte mjaft larg nga objektet ekzistuese, për t'i evituar problemet e shumta të ndërlidhura me efektin e mbivendosjes së ndotjes në zonat me përqendrimin të madh të popullatës. Në këtë rast:
 - a. objektet e reja termoenergjetike do duheshin të jenë me kapacitet sa më të vogël, jo më shumë se 2x400 MW, dhe të jenë të shpërqendruara sa më shumë. Ky opsion bëhet shumë i mundur kur të merret parasysh e dhëna se baseni i linjtit në Kosovë është i shtrirë shumë gjerë, dhe ofron sasi të mjaftueshme për eksploatim të qëndrueshëm të linjtit kudo që do të vendosejshin termocentralet e reja;
 - b. do duhej filluar menjëherë me studimet që do të përcaktonin investimet potenciale në energjetikë, duke u bazuar në rezervat e linjtit që gjenden në basenin e Drenicës dhe të Dukagjinit.
- vi) Të përfundohen sa më shpejtë studimet e potencialit energjetik ujqor në Kosovë. Në periudhën e ardhshme afatmesme do duhej filluar ndërtimi i kapaciteteve hidroenergjetike, dhe vetëm pas shfrytëzimit të këtij resursi do duheshin bërë planet afatgjata për shfrytëzimin e mëtejshëm të linjtit. Njëkohësisht, duhen studiuar mundësitë reale për shfrytëzimin e resurseve tjera alternative (erës, diellit, gazit etj.).
- vii) Së bashku me KEK-un të vepohet menjëherë në zvogëlimin qenësor të humbjeve teknike dhe komerciale të energjisë së prodhuar. Ky do të ishte "investimi" më i shpejtë, më efikas dhe bindshëm më i liri, më fitimprurësi dhe më i pastri për sigurimin e energjisë që aktualisht "mungon" në Kosovë. Duke zvogëluar humbjet, Kosova mund të sigurojë energji të mjaftueshme për të përballur krizën momentale dhe/ose për të "zëvendësuar" energjinë që prodhon termocentrali Kosova A.

Organizatave ndërkombëtare:

- viii) Të vazhdohet me zell të shtuar ndihma sektorit të energjisë në Kosovë, duke u përqendruar posaçërisht në ndihmën që duhet ofruar institucioneve qeveritare dhe KEK-ut për të studiuar mirë të gjitha opsionet në dispozicion për të zhvilluar sektorin energjetik, i cili do të sigurojë energji sa më të pastër dhe sa më me leverdi ekonomike për qytetarët e saj. Organizatat ndërkombëtare, posaçërisht Banka Botërore, AER-i, USAID-i, dhe SIDA, do të duhej të ndihmojnë dhe këshillojnë MEM-in në drejtim të sigurimit të më shumë opsioneve zhvillimore të energjetikës, dhe më shumë projekte alternative që do ta adresonin krizën aktuale energjetike, duke:
 - i. siguruar përmirësim të dukshëm të situatës së vështirë mjedisore të krijuar nga termocentralet;
 - ii. ndihmuar në evitimin e konflikteve ndërsektoriale, në rend të parë ndërmjet bujqësisë, zhvillimit urban, ekonomisë ujore etj.;
 - iii. zbutur tendencat e përkeqësimit të lëvizjeve sociale-demografike në këtë rajon industrial.
- ix) Të marrin qëndrim konkret karshi projektit 'Kosova C – 2.100 MW' dhe të distancohen nga prononcimi publik të cilin po e bën MEM-i se organizatat ndërkombëtare, posaçërisht Banka Botërore,

AER-i, USAID-i, dhe SIDA, qëndrojnë prapa këtij projekti, nëse realisht nuk qëndrojnë pas tij dhe problemeve të shumta që ndërlidhen me të.

- x) Të përkujdesen dhe të insistojnë që gjatë ndërtimit të termocentraleve të reja të zbatohen të gjitha kriteret, standardet dhe rregullativat ligjore ndërkombëtare (konventa e Aarhusit, protokollin e Kyoto-së etj.).
- xi) Të përkujdeset që rezultatet e studimeve të bëra nga ana e tyre si dhe kriteret që ato i aplikojnë në vende tjera të bëhen pjesë e procesit të vendimmarrjes për investimet e reja në Kosovë.

Shoqërisë civile:

- xii) Të fillojë ta adresojë këtë çështje jo vetëm si një projekt zhvillimor të një rëndësie të madhe për Kosovën por edhe si çështje e rëndësishme e ndërtimit të institucioneve demokratike.
- xiii) Të ofrojnë zgjidhje dhe alternativa bashkëpunimi me Qeverinë për të ngritur dukshëm cilësinë e vendimmarrjes demokratike dhe për të siguruar sundimin e ligjit.
- xiv) Të monitorojë zbatimin e ligjit dhe të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare gjatë procesit të vendimmarrjes dhe më vonë në fazat e implementimit.
- xv) Të bëhet pjesë e rrjeteve ndërkombëtare civile, në rend të parë të atyre rajonale, që merren me problemet e energjetikës dhe ngritjes së përgjegjësisë dhe transparencës, për të ngritur kapacitetin vetjak të veprimit si palë konstruktive në vendimmarrje, por edhe si grup presioni atëherë kur ka nevojë.

Korporatës Elektroenergjetike të Kosovës

- xvi) Të qartësojë pozitën e saj ndaj projektit 'Kosova C' dhe investitorëve të ardhshëm privatë lidhur me qymyrin, tregun, distribucionin, kuotat për emetim të CO₂, etj.
- xvii) T'i hartojë perspektivat zhvillimore të saj, duke i adresuar mundësitë e ngritjes së kapaciteteve të reja brenda kompleksit të saj energjetik (blloqet 3 dhe 4 të termocentralit Kosova B), si dhe të mbylljes së kapaciteteve të vjetruara (termocentrali Kosova A).
- xviii) T'i zvogëlojë dukshëm humbjet teknike dhe komerciale, duke bashkëpunuar me resorët e ndryshëm qeveritarë dhe organizatat ndërkombëtare.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

621.311.22:553.96(496.51)(042.5)
504.05(496.51)(042.5)

Një përrallë moderne : energji nga linjiti / Forum 2015 ;
[Autorë Luan Shllaku dhe Ekrem Beqiri] . - Prishtinë : Forum 2015, 2007
(Prishtinë : “Rezniqui”). - 43 f. : ilustr. me ngjyra ; 24 cm.

Parathënie : f. 1-5

1. Shllaku, Luan 2. Beqiri, Ekrem

ISBN 978-9951-506-01-4